

MEHMET ÇELIKU

SHËNIME MBI TË FOLMEN E NDROQIT DHE TË PEZËS (TIRANË)*

HYRJE

Krahinat e Ndroqit dhe Pezës ndodhen në perëndim të qytetit të Tiranës dhe i përkasin rrethit të Tiranës. Të dyja janë krahina kufitare dhe kanë përkatësisht këta kufij gjeografikë: Ndroqi kufizon me Shijakun (V.), me Durrësin (P.), me Kavajën (J.), me Pezën (L.); krahina e Pezës kufizon me Petrelën (L.), me Malësinë e Peqinit dhe Rogozhinën (J.), me Mëzezin e Vaqarin (V.) dhe me Ndroqin (P.).

Krahina e Pezës përfshin këto katunde: 1) Peza Madhe, 2) Peza Vogël, 3) Pezë Hëlmes, 4) Maknor, 5) Çaušh, 6) Dórëz, 7) Gurúr, 8) Grecë, 9) Pajûn, 10) Ballashêj. Krahina e Ndroqit përfshin: 1) Gërbllesh, 2) Zhurje, 3) Kërçukje, 4) Zbarqe, 5) Çoçje, 6) Varosh, 7) Sauqet, 8) Shesh, 9) Lagja Re, 10) Lagja Trek (9 dhe 10 janë lagje të katundit Ndroq), 11) Pinet, 12) Çale Bërzez.

Nga ana administrative Peza varej para Luftës nga Peqini, ku ndodhej edhe komuna, pas Luftës, gjatë tre-katër vjetëve, u lidh me Petrelën. Ndroqi ka qenë i lidhur me Shijakun dhe me Durrësin. Aktualisht (1965) këto dy krahina administrohen nga një lokalitet i vetëm me qendër në Ndroq.

Etnografikisht krahina e Ndroqit dhe ajo e Pezës nuk përbëjnë njësi etnografike të veçanta, çka shihet në veshje e zakone, që pak a shumë janë të njëjta.

Ndroqi dhe Peza janë kryesisht krahina kodrinore. Lumi i Erzenit kalon nëpër Ndroq dhe veçon disa nga katundet e Ndroqit në anën e djathtë të tij.

Banorët e Ndroqit dhe të Pezës merren kryesisht me bujqësi dhe më pak me blektori. Kultivojnë misrin, të lashtat, duhanin; kultura e ullirit dhe e rrushit është mjaft e zhvilluar.

Nranjakët (kështu quhen banorët e Ndroqit)¹ dhe pezakët i bënin pazaret

* Ky punim, i hartuar më 1965 dhe i diskutuar në Sektorin e gramatikës e dialektologjisë të IGj më janar 1966, botohet për herë të parë.

¹ Ka dokumente që provojnë vjetërsinë e emrit *Ndroq*, ndër trajtat fonetike të ndryshme të tij më e rëndomta është *Andronichi*. Më 1570 emri Ndroq shfaqet në trajtën *Andronellio*; Starine, XII, f. 198. Në një relacion tjetër, rreth vitit 1570, del në trajtën *Dronichi*, “Dulcigno secondo l’antica descrizione”, *Hylli Dritës*, 1936, f. 347. Kurse vendësit ndër dokumentet e kohës quhen rëndom *Andronici/Andronichi* (shek. XVI –

në Tiranë, Kavajë, Durrës e më rrallë në Shijak. Banorët e katundeve jugore e qendrore shkonin në Kavajë e më shpesh në Tiranë; ndonjë katund i krahut perëndimor, në të djathtë të Erzenit si Sauqeti, shkonin kryesisht në Shijak. Kjo varej nga afërsia gjeografike e qyteteve dhe nga lloji i mallit që tregëtohej. Pazaret organizoheshin në ditë të ndryshme të javës (në Durrës të premten, në Tiranë të enjten, në Shijak të hënën, në Kavajë të shtunën), çka mundësonte që banorët e të njëjtit katund të shkonin, madje brenda javës, në disa pazare. Banorët e katundeve të Pezës e Ndroqit, që të gjithë të besimit musliman, i bëjnë krushqitë me banorët e krahinave kufitare, por dhe brendapërbrenda katundit.

Punimi i pranishëm është hartuar në bazë të materialeve dialektore të mbledhura në katundet: (1) Kërçukje (K., lokalitet i Ndroqit) me mbi 120 shtëpi; (2) Sauqet (S., lokalitet i Ndroqit) me 60 shtëpi; (3) Maknor (M., lokalitet i Ndroqit, që konsiderohet katund i krahinës së Pezës, ekzaktesisht lagje e katundit Pezë e Madhe) me mbi 50 shtëpi. Gjithashtu janë përdorur edhe disa materiale të kufizuara që i kemi mbledhur në katundin Ndroq (Lagja Trek). Për katundet Kërçukje e Maknor materialet u mbledhën nga 25 qershor – 12 korrik 1963, ndërsa për Sauqetin nga 29 shtator – 8 tetor 1964. Në këto ekspedita të shkurtra dialektore materialet janë marrë nga subjektet (informatorët): 1) Ismail Asman Shaba, 2) Qamil Jonuz Gjoshi, 3) Dervish Sulejman Dervishi (Sauqet); 1) Ramazan Bajram Trimi; 2) Beqir Ibrahim Bleta; 3) Rexhep Mërsin Matera (Kërçukje); 1) Ramazan Seit Duraku, 2) Muharrem Ramazan Çelmeta (Maknor). Subjektet nga Lagja Treg të katundit Ndroq janë: 1) Islam Jusuf Anési, 2) Mahmut Beqir Alhysa, 3) Bajram Bajram Tufa. Të gjithë subjektet ishin të moshës mbi pesëdhjetë vjeç dhe që të gjithë analfabetë.

Ky punim është informativ përshkrues. Në të përshkruhen tiparet kryesore të së folmes së Ndroqit e Pezës, duke treguar shkallën e afrisë midis gjuhës së pezakëve dhe nranjakëve; por do të evidentohet edhe ndonjë dallim i kufizuar midis tyre. Në disa tipare gjuha e katundit Sauqet afron me të folmen e Shijakut. Sauqeti ndodhet gjeografikisht larg Shijakut vetëm tre orë rrugë në këmbë. Deri vonë Sauqeti administrohej prej këtij qyteti (më 1938 Sauqeti shërbente vetë si qendër komune e tetë katundeve). E folmja e Ndroqit dhe e Pezës do të krahasohet me të folme të tjera kufitare të grupit të gegërishtes jugperëndimore, pjesë e së cilës është, si edhe me tiparet e grupit të gegërishtes juglindore.

XVII), Pjetër Budi, 'Letra Gocadinos, Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII, vëll. I, I. Zamputi, 1963. Shih edhe I. Zamputi, *Studime Historike*, 1964/1, f. 95-123.

FONETIKA

Theksi

Ndryshe nga të folme tjera gege, shfaqen oksitone disa fjalë turke: *xhinazé, bakllavá, damllá, budallá* (S.), por në K. edhe *budáll*. Fjalë të tjera turke dëgjohen paroksitone: *káurr, magáze* (K.), *Fatíme, básme*, të cilat në disa të folme gege dalin ok sitone. Oksitone dëgjohen fjalët *aqi, kaqi, tétjé, huá*; fjala *gati* del herë oksitone (*gati'*), herë paroksitone (*gáti*). Dëgjohe rregullisht paroksitone fjala *dísa*. Përemri *ai* ka të theksuar elementin e dytë sa herë që luan rolin e një përemri-emër: *ai' i* ka pas punu: (M.), ra m'pust *ai'* (S.). Kallëzorja e përemrit *ky* del në variantin *két*, kur përdoret si përemër-mbiemër: ja maj *két* mu:r (S.); ke për t'qit *két* lajm M.); t'thurrim *két* garth (K.). Ndërsa e njëjta kallëzore, kur përdoret si përemër-emër, ka të theksuar zanoren *e*: shtin krushqit vra:n *kté* (K.). E njëjta dukuri konstatohet edhe në kallëzoren e përemrave *ai, ajo*: hajt t'bi:sh me *té* (K. përemër-emër); çy m'at koh jam msu: (K. përemër-mbiemër).

Sistemi zanor

Gjatësia e zanoreve

Sikurse edhe në të folme të tjera gege, zanoret e theksuara shfaqen të gjata, të mesme dhe të shkurtra.

Zanoret e gjata dëgjohen kryesisht në këto pozicione:

(1) Dëgjohe e gjatë zanorja e theksuar e fjalëve protonike, të cilave u ka rënë *ë*-ja fundore: *de:g, ka:sht; daja:k* (n. shum.), *kapu:ç* (n. shum.), *qe:n, pa:sh; shu:m, vo:n*. Si pasojë e rënies së *ë*-së fundore përftohe zanorja e gjatë edhe në fjalët me asimilim: *çu:n, ramaza:n, Hasa:n, Osma:n* (r. kallëzore).

(2) Dëgjohe e gjatë zanorja e përftuar nga monoftongimi i të gjitha diftongjeve në rrokje fundore të mbyllur a të hapur: *ftu:, th^hu:n, përru:n, bu:ll, kallnu:r, t'du:sh, t'mi:ll, qi:ll, kapërcy:ll*.

(3) Dëgjohe përgjithësisht të gjata zanoret në rrokje të hapur fundore: *ka:, tra:, sy:*. Kjo dukuri vihet re sidomos kur mbi zanore bie edhe theksi sintagmatik.

(4) Dëgjohe zakonisht të gjata zanoret e theksuara të fjalëve që ndodhen në rrokje të mbyllur para tingujve likuidë, sidomos, para *r*-së, më rrallë para *ll*-së: *gu:r, gamo:r, ushta:r, lita:r, kula:r, mulla:r, za:r; za:ll, py:ll, y:ll* etj. Por dëgjohe rregullisht e shkurtër zanorja e theksuar e fjalës *sheqër*.

Edhe në të folmen e Ndroq-Pezës takohen rastet e kalimit të zanores së gjatë a të mesme në të shkurtër. Kjo dukuri mbështet tezën e rrafshimit të

shkallëve të gjatësisë edhe në gegërishte². Ja disa raste të tilla: (a) Dëgjohet e shkurtër zanorja e theksuar e formave të kohës së tashme dhe të ardhmes m. dëftore dhe e së tashmes së lidhore në vet. I e të III shumës: *kthëjm, çojm, përgjōjm, copōjm, shkōjm; nalōjn, kōjn, ŋatrrōjn, gallxōjn, këñōjn; do msōjm, do gallxōjn; t'çōjm, ta shkarkōjm, t'kërkōjn, ta vërtetōjn*. (b) Në disa raste dëgjohen të shkurtra zanoret e theksuara të formave të së kryerës së thjeshtë të vetës së I e të III shumës; të tilla zanore të shkurtra dëgjohen dendur në S.: *u ŋrēm (M., K., S.), nëjm (M.), pātñ (M.), fjētm (S.); nëjn (K.), hīkn (S.), vđiqn (S.), dūln (S.)*. (c) Në disa raste emrat në trajtën e shquar shumës e kanë zanoren e theksuar të shkurtër pavarësisht rënies së mbaresës -ë të shumësit: *partizān > partiza:n > partizānt, shōk > sho:k > shōkt, por tekni:kt*. (ç) Në pjesore disa folje dalin me zanore të theksuar të shkurtër: (ka) *vdëk, (kam) vjël, (kam) gjët*.

Në shumësin e emrave me metafoni nuk konstatohet gjatësia analogjike që dëgjohet në disa të folme të tjera: *dāc > dēc* (e jo *de:c*), *gugāsh > gugēsh* (e jo *guge:sh*), *dāsh > dēsh* (e jo *de:sh*), *cāp > cēp* (e jo *ce:p*).

Kur ndiqet nga një zanore tjetër, zanorja e theksuar dëgjohet me gjatësi të shkallës së mesme: *kërkō.ĭ besō.ĭ, përrō.ĭ, ftōj, patkō.ĭ, kă.u, mĭ.u*.

Ndryshe nga disa të folme të tjera geqe, është e shkurtër zanorja e theksuar për disa folje të zgjedhimit të parë e për disa folje të parregullta, vet. II dhe e III nj.: *hiñëllĭn (S.), qān, (M.), hān (K.), dĭn (M.), pĭn (K.), shtjĕn (K.), vĭn (M.)*.

Ndonjë ndajfolje dëgjohet me zanore të theksuar herë të gjatë, herë të shkurtër: *ku:rr / kŭrr*. Rregullisht kanë zanore të gjatë emrat: *bu:lk, bu.ĭ, shy:t*.

Hundorësia

Të gjitha zanoret e theksuara dëgjohen hundore në rastet që vijojnë:

(1) Para një bashkëtingëlloreje hundore (*n, m, ŋ*): *zâ.°ni, trĭ:n, kaptĭ:n, kĭ.na, rrŭ:nx, ên, qĭ.me, hĭ.me, kâ°m, kŭñjĕll, apêŋa, hâ°ŋjër*.

(2) Para bashkëtingëlloreve hundore *n, m, nj, ŋ*, të cilat kanë rënë ose kanë evoluar në një tjetër bashkëtingëllore johundore: *zâ°, gjâ°, â, hŭ, drŭ, e êjte, dullĕj, mullĕj, rêj, gjarpĭj, kŭull*.

(3) Kur paraprihet nga -j e prejardhur nga *nj* ose *ngj*: *jĕf, jâ:l, fĕjĭ:ll; në* ndonjë rast edhe mund të bjerë, si *ĭshet* (= ngjshet). Por në S. *ja:l, jĕsh, e jallme*.

(4) Në disa fjalë të caktuara kur pasohen aktualisht nga -h: *qêhe, gjŭhja, frĕhĕn, strĕhe, krâhĕn, plĕhi*.

(5) Në mjaft fjalë vihet re hundorësia analogjike, dukuri që prek kryesisht *i*-në fundore të theksuar: *kusĭ, saksĭ, tepsĭ, tagjĭ, kutĭ, gjĭ:z, tĕrhŭ, kâ*.

Nuk dëgjohen hundore zanoret e theksuara në fjalët *ra* (kishte ra), *thu > thoj*.

² M. Çeliku, "Mbi dallimet kuantitative në shqipet", kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor, IGJ, 1964.

Edhe në këtë të folme intensiteti i hundorësisë varet nga gjatësia e zanores e lloji i saj dhe pikërisht intensiteti i hundorësisë është i një shkalle më të lartë te zanoret e gjata: *prû:*, *kapfî:n*, *ullî:sht*, *fî:*, *kî:z*. Përkundrazi, është më i ulët te zanoret e shkurtra: *hûj*, *ullît*, *mîj*. Gjithashtu, hundorësia e zanoreve *a*, *i* është e një shkalle më të lartë se e zanores *o*. Zanorja *a* e ruan hundorësinë edhe kur labializohet: *pëllâ:°m*, *kâ°m*, *kó:°nk*, *dhónrri*, *mâ°jt*, *bâ°jte*, *gjâ:°t*. Intensiteti i hundorësisë është më i lartë edhe kur bashkëtingëllorja hundore që shkaktoi hundorësimin, ka rënë, si në fjalët: *shpû:z*, *ullî:sht*. Për rrjedhim, intensiteti i hundorësisë analogjike është i një shkalle më të lartë.

Zanoret në rrokje të theksuar

â. Është më e prapme dhe më e mbyllët se *â*-ja e theksuar hundore e të folmes së Elbasanit, duke iu afruar një *o*-je të hapët. Labializimi i *â*-së është një dukuri e përgjithshme, por shkalla e labializimit nuk është e njëjtë. Në disa raste labializimi është më i theksuar duke iu afruar një *ó*-je pak të hapët: *kóm*, *shtóz*, *dhónrri*, *kónk*, *hónza*, *njóni*, *bójte*. Varianti më i zakonshëm është *ó°*, një *â* e prapme e mbyllët: *â°nërr*, *gjâ°*, *shkâ°mi*, *bardhâ°jt*, *tâ°mël*. Në pak fjalë *â*-ja dëgjohet shumë e mbyllët: *fullâ°nza*, *rrâ°ja*, *mâ°n*, *e há°n*, *bâ°n*. Së fundi, kemi takuar fjalë të pakta ku *â*-ja nuk është labializuar aspak: *bërthâm* (K.), *tagâj* (K.), *krâhen* (M.), *fullâx* (S.), *mâz* (S.).

Lidhur me dukurinë e labializimit, vihen re dallime midis pikave të ndryshme të banuara; kështu në K. labializimi është më i theksuar: në K. dëgjohet *dónt* - në S. *dâ°nt*. Gjithashtu vihet re se ndryshon shkalla e labializimit edhe gjatë trajtëndryshimit: *bâ°n* (K. pak labiale) > *mâ°ni* (M. shumë labiale); *shkâ°m* (M. pak labiale), *shkâ°mi* (M. shumë labiale), *thâ°n* (S. shumë labiale), *thâna* (S. jo labiale). Vihen re dallime ndër subjekte. Kështu, subjekti (1) e shqipton *â*-në më labiale se subjekti (2).

a. Zanorja *a* e theksuar jo hundore që paraprihet nga *m*, *n* është labializuar në *a°* në të shumtën e rasteve. Në dallim nga e folmja e Krujës, në të cilën *a*-ja e këtij pozicioni ka një shkallë të vogël nazaliteti³, në të folmen e Ndroq-Pezës, në Kavajë⁴ dhe në Peqin⁵ dëgjohet *a* gojore: shembuj fjalësh ku *a*-ja paraprihet nga *m*: *gama°r*, *sama°r*, *ma°j*, *ma°gje*, *ma°zi*, *dama°te*, *ba°mje*, *ma°c-i* (një lloj krimbi, që lëviz sikur e mat vendin); shembuj fjalësh ku *a*-ja paraprihet nga *n*: *tina°r*, *na°ta*, *kana°k*. Buzore dëgjohet edhe *a*-ja te *mja°lt-i*.

Luhatje midis varianteve *a/a°* vihen re ndër pika të ndryshme të banuara si dhe gjatë trajtëndryshimit të fjalëve: *marr* > *do ta ma°rri* (S.), *mall* > *ma°llin*

³ J. Gjinari, "Vëzhgime mbi të folmen e Krujës", *Studime filologjike*, nr. 3/1964, f. 94.

⁴ M. Çeliku, *Të folmet e krahinës së Kavajës*, dorëshkrim i pabotuar, f. 6.

⁵ M. Çeliku, *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, dorëshkrim, f. 9.

(S.), *mjalt* > *mja^olti* (M.), *mal* (S.) > *Muç Ma^olit* (K. toponim); *mars* (S.) > *marsi* (S. por *ma^orsi* (K.).

Në fjalët *zile*, *friik*, në dallim nga gegërishtja juglindore, *i*-ja e theksuar gojore është labializuar, në vend të së cilës dëgjohej rregullisht *y*: *fry:k*, *zy:l*. Krahas kësaj, *y*-ja dëgjohej edhe në fjalët: *krym*, *kry:p*, *gjymsa*. Në S. kemi ndeshur edhe *gjymra* (për gjurmë), *kryshq* (për krushq). Ruhet *i*-ja e theksuar te *ship:rt*, *bri:m*, *ushqim*, *qime*.

Në S. *o*-ja gojore e theksuar ka evoluar në *u* në fjalët: *çujn* (çojnë), *puqëm* (poqëm), *përdurin* (përdorin). Në K. në ndonjë fjalë dëgjohej një *o* më e prapme e më e hapët se ajo e zakonshme (*sot* > *sa^ot*).

Zanoret në rrokje të theksuar

Ë-ja pas rrokjes së theksuar

(a) Ka rënë rregullisht *ë*-ja në fund të rrokjes fundore, pavarësisht faktit se ç'pjesë e ligjëratës dhe ç'formë gramatikore ka fjala: *to:k*, *fry:k*, *gu:r* (sh.), *jasti:k*, *e ze:z*, *rrethōjn*, *qatrrōjn*, *përpje:t*. (b) Në shumicën e rasteve ruhet *ë*-ja e rrokjes fundore të mbyllur, sidomos kur mbyllet nga një sonante: *misër*, *lepër*, *katër*, *ta^omël*, *t'vegjël*, *plêhën*, *krâhën*, *lopën*, *u shemën*; *gocës*, *m'rrugët*, *durët*. Në dallim nga të folmet e gegërishtes juglindore, në shumë raste *ë*-ja nuk dëgjohej në rrokje fundore të mbyllur nga bashkëtingëllore jasonante, si në trajtën e shquar të shumësit të emrave me *-ë*: *dha:mt*, *gamo:rt*, *fyshe:kt*, *toktorrt*, *kula:rt*, *kapa:kt*, *partizant*, *shokt*, *tabakt*, *lita:rt*, *botukt*; në format rasore të zhdrejta të emrave: *dits*, *hoxhs*, *dallnyshs*, *qets*; në disa mbiemra: *i la:gt*, *i ftoft*, *i nroft*, *i vokt*, *i idht*, *i rrumbulla:kt*, *shkreps*; në disa forma të së kryerës së thjeshtë: *du:ln*, *gjetn*, *hikn*, *pâtn*, *u nism*, *erdhm*. Gjithashtu nuk dëgjohej *ë*-ja në rrokje fundore që mbyllet nga bashkëtingëllore sonante ose jo sonante, kur pas vjen një fjalë që nis me zanore: *n'fushne Shijakut*, *buzne xhades*, *Pezne Vogël*, *gocne filanit*, *katra pes dit*, *pente gjata*. (c) Rregullisht nuk dëgjohej *ë*-ja e një rrokjeje në trup të fjalës, që vjen fill pas rrokjes së theksuar: *kapistra*, *misri*, *urdhni*, *krâhni*, *plêhni*, *frêhni*, *qumshin*, *kopshta*, *t'doptit*.

Ë-ja para rrokjes së theksuar

(a) Në rrokje nistore të hapët pas së cilës vjen rrokja e theksuar, herë është ruajtur, herë është reduktuar deri në zero: *përru:*, *tëly:n*, *cëfurk*, *lëkur*, *këriklla*, *mështjerr*, *dërra:s*, *mëzat*, *përrallza*, *shëkoj*, *kënaq*, *qëroj*; *fmi*, *vlla*, *kpu:c*, *shpi:*, *shno:sh*, *rrefej*, *msoj*, *mshtetna*, *ngjoj*, *kpus*, *mshtolla*, *kshu*, *ktu*. I njëjti subjekt *ë*-në e këtij pozicioni në fjalë të caktuara i shqipton pa luhatje, si: *përru:*, *lëku:r*, por *fmi: vlla:*; (b) Në rrokje nistore të mbyllët pas së cilës vjen rrokja e theksuar, zanorja *ë* ruhet rregullisht: *përme:n*, *përte:k*, *kërbishtat*,

pëstiqe, mësteqe, fërgoj, pëlhu:r, mëlçî, tërpje:t; rrallë herë bie ë-ja në këtë pozicion dhe kjo shoqërohet me reduktimin e ndonjë bashkëtingëlloreje: *e mku:r* (e mërkurr), *psi:* (përsi, përsëri); (c) Përgjithësisht bie ë-ja në një rrokje në mes të fjalës pas së cilës vjen rrokja e theksuar: *thatsi, malsi, ushtri, njarrojm*, por *u vorfënu:n*; (ç) Bie rregullisht ë-ja në fjalët atone proklitike: *n'dallap, m'rrugët, t'njarrojn* etj.

u. Zanorja *u* përpara *ll, r* ose kalon në *ë*, ose ruhet. Në M. e K. në shumicën e rasteve kalon në *ë*, ndërsa në S. ruhet *u* para bashkëtingëlloreve sonante: *sumëll, kumëll, sjetëll, vetëll, ufëll, ma°shkëll, kërikëll, avëll, kujëll, turtëll* (M.), *shpatëll, kumëll, ufëll, sjetëll, sumëll, turtëll* (K.); por *pjegull, sjetull, trutull, akull, shakull, popull, hîskull, kumull, pjergull, vishkull, vetull, hekur, flutur* (S.), *mashkull, sjetull, njegull, karrikull, pjergull, popull, kuñull, bukur, hekur* (K.).

Reduktimi i *u*-së nga *ë* deri në zero ndodh sa herë që ajo kalon nga një rrokje postonike në semipostonike: *shaklli, vishklli, trutlli, shpatlla, vetlla, poplli, pjerglla, sjetlla, lepri, hekra*.

Dëgjohen fjalë, sidomos në S., ku zanorja e patheksuar *u* është reduktuar deri në zero kur ndodhet në fund të rrokjes fillestare a të rrokjes së mezit të ndjekur nga një rrokje e theksuar: *mllar, mllî, mllîs, pllum, kukvajk, bubllî:n, zblon*.

o. o-ja protonike e një rrokjeje fillestare kalon në *a* në shumë fjalë: *gamor, karrik, kathec, axhak, dama°te, kanok, taktorr, apejat, Asman, dallap, kasit, kallaj*. Dukuria është e përgjithshme.

a. Zanorja e patheksuar *a* në rrokje fillestare të disa fjalëve dëgjohet më e prapme, duke afruar nga shqiptimi me një tingull midis *ë* dhe *e*, që po e transkriptojmë *â*: *kâçup, kâllî, zjârm, mâqi:n*. Varianti *â* takohet shpesh në M.

Diftongjet

ue. Procesi i monoftongimit të *ue*-së në *u*., pavarësisht pozicionit, ka përfunduar plotësisht: *ftu:, kru:, gru:, thu:, përru:, çu:, shku:,blu:, këрку:*; *kallnu:r, fru:r, qershu:r, krahanu:r, tu:ll, mu:r (mori), du:l, mshtu:ll, pu:ll* etj.

ye. Edhe monoftongimi *ye > y*: aktualisht ka përfunduar plotësisht: *kry:, ly:, përlý:, shkëly:, kthy:, thy:, rrëmy:; kapërcy:ll, tly:n, kthy:n; pyste, thyjshim*.

ie. Diftongu *ie* kalon në *i:je*. Kështu, tek emrat monoftongohet në *i*: (*di:ll, qi:ll, mi:ll*), e cila në trajtën e shquar dëgjohet e mesme (i.): *di.lli, qi.lli, mi.lli*. Dëgjohet *je* te emri *e dje:l* (në të gjitha pikat e banuara). Ndërkaq te foljet *ie* dëgjohet *i:je* (e fundit takohet kryesisht te format e pashtjelluara): *ti:r, pi:ll, mshti:ll, bërzi: po mi:ll, po ni:ll, shti:, t'bi:sh; kom mje:ll, ka pje:ll, ka pjek, keni sje:ll, tuj tjerr, tye vje:ll, tue vjel, pa mjell, mjellim, mshtjellim, rrjedh, po vjel, shtjeva*.

Sistemi bashkëtingëllor

h. Në krye dhe në trup të fjalës bashkëtingëllorja *h* ruhet mirë: *hî:*, *he:r*, *hulli*, *ha*, *hejrrët*; *plêhën*, *krahe*, *frêhën*, *qêhe*, *krâhën*, *ahe*, *beha:r*, *i xêhët*. Shqiptohet e pareduktuar edhe *h*-ja antihiatizuese te pësorja e foljeve: *kthehi*, *ruhu*, *lahu*, *smuhet*, *lahna*, *fahet*. Në disa fjalë *h*-ja është reduktuar, si: *yzmet* (K., M., por *hyzmet* në S.), *baxhe* (M.), *ardhi* (S., por *hardhi* në K.), *vjerr* (S.). Në dy fjalë dëgjohet rregullisht një *h* protetike: *hik*, *heci*.

Në një numër të konsiderueshëm rastesh vihet re dukuria $h > f$, karakteristike për *h*-në fundore, sidomos te foljet dhe emrat e mbiemrat foljorë të prejardhur nga këto folje: *ftof*, *shof*, *mçef*, *rraf*, *jof*, *kref*, *mërdhif*, *pref*, *lef*. Fjalë të tilla e ruajnë *f*-në edhe kur kalon në trup të fjalës në formëndryshim: *shofim*, *krife*, *mërdhifin*, *nyefi*, *jôfka*, *nyofshim*, *u ftofe*, *rrifet*. Siç thamë, dukuria $h > f$ vihet re edhe tek emrat e mbiemrat foljorë e në ndonjë fjalë tjetër: *i ftoft*, *t'ftoftit*, *e nyefmja*; *gynaf*, *Mafmut*.

nj. Hundorja qiellëzore *nj* ka evoluar në të gjitha pozicionet: në fund të fjalës ka përfundue në *j* ose në një tingull gjysmëzanor *j*: (a) te foljet që dalin në temë me zanore: *bâj*, *gërmoj*, *harroj*, *fitoj*, *kërkoj*; (b) te shumësat e disa emrave mashkullorë: *hûj*, *ftoj*, *kërcûj*, *mêtîj*, *ullîj*, *drapîj*, *gjarpîj*; (c) tek emrat femërorë që kanë pasë një *nj* në temë: *gështêi*, *mllêj*, *rrâ`i*, *rêj*, *dullêj*. Në trup të fjalës *nj*-ja ka përfundue gjithashtu në *j*: *e êjte*, *mullêja*, *dullêje*, *zôjat*, *rrâ`jêt*, *shtrêjt*. Në trup të fjalës dëgjohet *nj*-ja e përfutuar nga evoluimi i elementit *i* të mbaresës *-ni* të urdhërores pas së cilës vjen një përemër enklitik: *merrnje* (< *merrni* + *e*), *millnje*, *ulnje*, *hanje*, *futnje*, *myllnje*, *lidhnje*.

Në fillim të fjalës *nj*-ja ka evolue në *j*, ose në disa raste ruhet. Lëkundja vihet re edhe te i njëjti subjekt: *jeri*, *je`gull*, *i jelbêt*, *jâ`ni*, *jôf*; *njerk*, *njegull*, *njeri*.

Bashkëtingëllorja *nj* tek fjala *nji* ka evolue, e si rezultat i kushteve të ndryshme fonetike është reduktue në *i* / *j*: mu ka zotu: *i* mik (K.), mdhem *i* krahe (M.), çer t`baj me *in* (K.), kishin ardh deri *mej* shpi aty (K.), dulën *kaj* çik (M.).

rr. Dridhësja e gjatë *rr* dallohet mirë nga *r*-ja në të gjitha pozicionet. Në disa fjalë përdoret *rr* për *r*, por jo në të gjithë krahinën: *e mku:rr*, *mjekërr*, *zjerrm*, *thunërr* (K), *zeherr* (S.), *taktorr* (S.), por në S. *e mkur*, *mjekër*; në S. dëgjuam *r* për *rr* edhe te *nëroj*.

dh. Bashkëtingëllorja *dh* pëson një reduktim, por në një shkallë më të kufizuar sesa në të folmen e Kavajës⁶. Takohen raste ta asimilimit të *dh*, kur ndjek menjëherë bashkëtingëlloren *r*; në këtë rast përfutet *rr*: *nyorr*, *errm*. Rastet janë të rralla dhe takohen kryesisht në M. e K. Në ndonjë fjalë *dh*-ja

⁶ M.Çeliku, *Të folmet e Kavajës*, dorëshkrim, f. 13.

është zëvendësuar nga një *ll* jo fort e qartë: *kull, zje:ll, shkallis* (S.).

th. (1) Në K. dhe M. *th*-ja dëgjohej në të gjitha pozicionet jo si një tingull i pastër interdental, por si interdental grykor (*th^h*); elementi grykor i këtij tingulli është më i dobët se në Peqin e Kavajë: *th^hi:k, th^ho:j, th^hâ^o:n, kth^hëjm, dja:th^h, gjokth^h, vâth^h*. Megjithatë ka fjalë me një *th* të pastër: *thelb, tho:t* (M.), *tho:t* (K.). Luhatje takohen tek i njëjti subjekt. Në S. *th^h* nuk takohet fare: *ther, thi:k, djath*. (2) Në disa fjalë spiranti ndërthëmbor *th* alternon me spirantin labial *f*: *fe:ll, ufull, fërmija, fullâ'nza*; në M. *fërres*; në S. *fënil*, por *thëll* (K.) dhe *thënil* (M.).

q, gj. Bashkëtingëllorja *q*, kur paraprihet nga *s, sh*, gjithashtu bashkëtingëllorja *gj*, kur paraprihet nga *z*, dhe pasohen nga një zanore, kalojnë në *j*: *sjăp* (>*sjëp*), *sjapth, sjetull, sju:k, asjer, sjepar; shjarth (shjërth), shjo:p, ke Shjopza* (toponim); *zju:, zje:dh, zjeth, (â) zju.* Kjo dukuri është e përgjithshme; vetëm në K. kemi dëgjuar *pasqyr e basqyr* dhe *zju:*.

s. Fishkulljesja *s* shumë herë zëvendësohet nga afrikatja *c*, sidomos para zanoreve të theksuara, ndonjëherë edhe para bashkëtingëlloreve të shurdhëta: *cap* (shumës *sjëp*), *aci, cipër, kacolle, mickôj, përdheck*. Në K. edhe *capu:*.

Grupe bashkëtingëlloresh

mb, nd. Këto dy grupe asimilohen plotësisht në çdo pozicion fonetik, duke dhënë përkatësisht dy bashkëtingëlloret sonante *m, n*: (a) *mje:ll, mleth, my:ll, kumo:n, kumull, dhâm, hum, trem*; (b) *něj, naloj, ne:r, mrena, shënre, anej, ven, katun, tun*. Përgjithësisht *n* (<*nd*) është një bashkëtingëllore okluzive hundore alveolare-dhëmbore, por herë-herë, kryesisht në trup të fjalës, duket thjesht dhëmbore e jo alveolare-dhëmbore (n): *dhâ ñërr, katun*ï*, thunërr*. Grupi *nd* dëgjohej në fjalën *sônde*; në K. elementi i dytë i grupit është shurdhuar në fjalën *sent*. Është asimiluar edhe *nd* e përfutur nga elementi konsonantik *n* i parafjalës *në* të reduktuar, dhe bashkëtingëllorja nistore *d* e fjalës pasuese: ja mu:r *no:r* (= *në dorë* > *n'do:r* > *no:r*).

ng. Grupi *ng* është asimiluar dhe në të gjitha pozicionet ka dhënë një tingull okluziv hundor grykor *ŋ*: *ŋul, tye ŋa, ŋordh, ŋel; shtërrjo, shtërrjes, haŋër, apêŋa, lâŋ, luŋ*.

Në ndonjë rast grupi *ng* është reduktuar plotësisht: *gû* (M.), *kûull* (> *kûuj*) (M., K., S.), *e ûsht* (S.), *ûl* (S.). Emrat *cungal* e *çengel* dëgjohen *cujâl* > *cujâj* (M.) dhe *çejel* (S., M., K.).

ngj. Ky grup është asimiluar dhe ka dhënë rezultate të ndryshme e pikërisht: *nj, j*, në disa raste nuk ka lënë asnjë gjurmë. Zhvillimi fonetik i grupit *ngj* në këtë të folme nuk shfaqet uniformë.

Bashkëtingëllorja palatale *nj* (<*ngj*) takohet kryesisht në M. dhe më rrallë në K.: *njala, thënjill, njesh, njit, zenjin, njat* (M.); *nja:l, njesh, zenji* (K.).

Në S. *j* (<*ngj*) është rezultat kryesor i evoluimit të *ngj*: *ja:l*, *e jallme*, *jesh*, *jît*, *mjes*. Por *j* (<*nj* <*ngj*) takohet, krahas *nj*, edhe në K.: *ja:l*, *jesh*, *jît*, *jâll*, *fëjÿll*, *zejÿn*; gjithashtu edhe në M.: *zëjÿn*, *jâl*.

Së fundi, në të gjitha pikat e banuara nuk dëgjohet asnjë element i grupit *ngj* në fjalët *qÿ* (<*qÿngj*); *zëÿn* (K., M.) dhe *thëÿll* (K.). Në S. grupi *ngj* në fjalën *thëngjill* është reduktuar në *n*: *fëÿnill* ose dhe *thëni:ll*.

tj, dj. Në Ndroq e Pezë grupet *tj*, *dj* ruhen në çdo pozicion fonetik (nuk kemi takuar asnjë rast asimilimi të tyre): (a) *tjegëll*, *tjetër*, *tjerr*, *mështjerr*, *atje*; (b) *dja:l*, *dja:th*, *djers*, *djepe*, *dje*.

pl, bl, fl. Grupet bashkëtingëllore *labial* + *l* ruhen mjaft mirë në Pëzë dhe në pjesën më të madhe të Ndroqit: kështu, në M. dhe K. nuk kemi takuar asnjë rast zhvillimi të tyre: (a) *ble:t*, *blej*, *bluj*; (b) *plis*, *plak*, *plehën*, *plot*; (c) *flo:k*, *fle:t*, *flas* etj.

Por në veri të Ndroqit në zonën kufitare me Shijakun konstatohet një zhvillim i elementit *l*, të paraprirë nga një labiale dhe, si rrjedhim, *pl>pj*, *bl>bj*, *fl>fj*. Në S. ky fenomen është përgjithësuar: (a) *pjak*, *pjaçka*, *pjâ°ns*, *pjâ°ni*, *pjâ:°n-a*, *pja:g*, *pjep*, *pjesht*, *pjuhën*, *pjuk*, *pju:r*, *pjuhën*, *pjot*, *pjas*, *përpjas*, *shupja:k*. Elementi *j* i grupit të fjala *plis* nuk dëgjohet fare, duke u asimiluar nga zanorja pasuese *i* (në S. rregullisht dëgjohet *pis*); (b) *bje:t*, *bjej*, *bjuj*; (c) *fja:k*, *fjâ°m*, *fjo:k*, *fje:t*, *fjas*, *ffej*, *fjori*, *fjamu:r*, *fjuroj*. Kjo dukuri ndodh në pozicione të ndryshme fonetike: në rrokje nistore ose në trup të fjalës, në rrokje të theksuar ose të patheksuar, por ka një shtrirje gjeografike të kufizuar, pikërisht në zonën pranë Shijakut, zonë ku dukuria është mbizotëruese.

lk. Në grupin bashkëtingëllor *lk* elementi *l* ruhet në fjalë si: *bu:lk*, *bu:lk* (insekt), *bulksi*; ruhet *l* edhe kur grykorja *k* palatalizohet në shumës: *bu:lq*. Ka rënë *l* e grupit *lk* te emri *uk* (> *uq*).

kl, gl. Këto grupe kanë kaluar përkatësisht në *q*, *gj*: (a) *qumësht*, *qi:sh*, *qina* (klinda), *qa:i*, (kam) *qe:n*; (b) *gjisht*, *gjû*, *gjem*. Grupet *kl*, *gl* janë palatalizuar në *q*, *gj* edhe në fjalë që në të folme të tjera të gegërishtes juglindore kanë ndjekur një rrugë tjetër zhvillimi (në Elbasan *gisht*, *ki:sh*, *kin*). Në S. dëgjohet trajta *shkeleva*, ku grupit *kl* i ndërfitet zanorja *e*.

fsh. Grupi bashkëtingëllor *fsh* ruhet në një numër të konsiderueshëm fjalësh, si: *ko:fsh*, *gri:fsh*, *la:fsh*, *mna:sh*; gjithashtu edhe në format e mënyrës dëshirore: *rrofsh*, *qofsh*, *pafsha*, *kërkofsh*. Në disa fjalë të tjera, si edhe në të folme të tjera të Shqipërisë së Mesme, dëgjohet grupi *msh* në vend të *fsh*: *mshe:s*, *mshi*, *mshtes*, *mshtjell*. Variantin *mç* të *msh* e kemi ndeshur te *mçef* (në K. edhe *çef*). Elementi i dytë i këtij grupi dëgjohet vetëm te fjala *t'shtirshme* (S.).

Fenomene fonetike

Shurdhimi

Bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës dhe para bashkëtingëlloreve të tjera të shurdhëta shurdhohen në gjegjëset e tyre:

(a) *garth, lith, erth, zbarth; thelp, rop, korp, kalp, shtek, brek, vark, pluk, qemes, t'zes, varq.*

(b) *ta huthsh, trathtoj, n' letht, trithte nanën, liksu:, i likt, lakshim, trektia.* Në K. dëgjohej *q* (<*gj*) të fjala *laqa*. Gjithandej shurdhohet *d* nistore te fjala *taktorr*.

Nuk shurdhohen bashkëtingëlloret e zëshme pas një zanoreje të gjatë në fjalë, që kanë pasur një *ë* fundore dhe që sot ka rënë: *mi:z, shko:z, ko:v, ta:v, e do:b.*

Sonorizimi

Në të folmen e Ndroqit dhe të Pezës, si dhe në të folme të tjera të gegërishtes jugperëndimore, konstatohet fenomeni i sonorizimit të disa bashkëtingëlloreve të shurdhëta, kryesisht *p, k*, kur ato ndodhen në ballë të fjalës: (a) *bërdaq, bërziq, bërzihet, bështoj, bëstiqe, bortokall, basqyr*; por jo çdo *p* fillestare sonorizohet, kështu mbetet e shurdhët *p*-ja te fjalët *përza, pëlqej, përte:k* etj.; (b) *gallxoj, gejtaj a gitoj*; në B. edhe *gërgoj, gërthija*.

Në S. sonorizohen *p, k* e ndonjë tjetër bashkëtingëllore edhe në trup të fjalës: *gjarbën, drabën; patogu; goda, plá^ozin*. Me sa duket, dukuria ka një shtrirje më të gjerë në S.

Asimilimi

Dukuria e asimilimit nuk takohet në grupe bashkëtingëlloresh, por kryesisht në sistemin vokalik: *koho, lukur, dere'za, çubuk, akallaj* (turq. *okllagî*), *berek*. Në S. ndeshen raste asimilimi në distancë të zanores *o* në pjesëzën *po*, kur pasohet nga përemri i trajtës së shkurtër *e*: *pe e fusim m'hara:rt, pe e kryp, pe e pejoj qi mos hiki, pe e lith* etj.

Metateza

Shumë fjalë i nënshtrohen fenomenit të metatezës. Disa prej tyre përdoren rëndom: *shloj* (edhe *çloj*), *bështoj, bërkushe, vlo:çk, hurdha*; por edhe *përshit, dërtoj, arxoj, bërko:ck, gjymra* (gjurmë). Kudo dëgjohej *menec* (sllav. *nemec*).

Rënie tingujsh

Bashkëtingëlloret që bien më shpesh janë *t, r*. Kjo ndodh si pasojë e reduktimit deri në zero i zanores *ë*, me të cilën ato formësonin një rrokje të patheksuar të fjalës.

Zakonisht bie *t*-ja e togut *sht*: *qumsi, ship, ash, gjashqin, kshu, ashu*, po

(në rastin e fundit bie i gjithë togu *sht*). Gjithahtu reduktohet edhe *t*-ja fundore e ndonjë fjale tjetër, si *luf*, *iim*.

Reduktohet edhe bashkëtingëllorja *r* në rrokje të patheksuar, si: *e mkur*, *qeshur*, *pëshesh*, *beshti:c*, *psi*.

Përveç *t*, *r* ka raste të rënies edhe të ndonjë bashkëtingëlloreje tjetër: *pu:c*, (këpucë), *puta* (këputa), *të kija* (të këqija) etj.

Elizioni

Në togfjalëshat e përbërë nga një emër femëror a mashkullor në trajtën e shquar dhe një emër në rasën gjinore të shquar ose mbiemër të nyjshëm, nyja e përparme e komponentit të dytë nuk dëgjohet: (a) *lafsha gjelit*, *trîna dorës*, *neja qetes*, *miza bletës*, *Kodra Karrikut*, *Kodra Gja:t'*, *vjeshta dy:t*, *nusja re*; (b) *çuni tezes*, *shtufi krahit*, *qulli groshës*, *qumshi tun*, *burri hershëm*, *burri mi:r*.

MORFOLOGJIA

Emrat

Gjinia e emrave

1. Emrat e gjinisë asnjane, që tregojnë lëndë, nuk ruhen. Ata kanë kaluar në gjininë mashkullore, rrallë herë në femërore: *djathi*, *tlyni*, *leshi*, *mja^olti*, *dylli*; në S. *ynyri*, *lla:llk -a* (në M. edhe *llallta*). Ndonjë asnjane që ka pasur nyjën e prapme *t* në trajtën e shquar i mbishtohet edhe nyja *i* e gjinisë mashkullore: *u:^oi* > *ujti*, që është forma e vetme.

2. Në Ndroq e Pezë janë të gjinisë femërore edhe disa emra, të cilët në të folme të tjera dalin si emra të gjinisë mashkullore, si: *llallka (dhallta)*, *fustanja*, *pylla*, *nyja (neja)*, *Erzenja*, *lama*, *sabahja*, *strêhja*, *tûhja*, *tulja*, *turpja*.

Për sa i përket gjinisë në pika të ndryshme a në të njëjtën pikë të banuar vihen re luhatje, kështu, emrat *shnet*, *qiell* dalin në gjininë femërore *shnetja* (S., K.), *qillja* (K., në M. *qilla*), por *shneti* (M.), *qilli* (S.). Ndërsa disa emra, që në të folme të tjera janë të gjinisë femërore, këtu dalin në gjininë mashkullore: *furri*, *jugu*, *minuti*, *neri*, *brîni*, *rrashti*, *teli*. Pjesa dërrmuese e këtyre emrave (grupi 1 dhe 2) kanë gjini të ndryshme në të folmet e gegërishtes juglindore.

3. Ndonjë emër i përveçëm lakohet sipas paradigmës së emrave femërorë, megjithëse nga gjinia natyrore është mashkullor: *Gania*, *Shyqyrija*, por *Nuriu*, *Sabriu*.

Shumësi i emrave

1. Shumësi më i përhapur është ai me mbaresën *-a*. Këtu kemi regjistruar mbi 60 shumësa të tillë. Ky tip shumësi përdoret në vend të shumësave me *ë*, me *ënj*, *inj*, me jotizim të ndonjë bashkëtingëlloreje të temës etj.

(a) *bastana*, *bërryla*, *cuçala*, *çakalla*, *çejela*, *çekiça*, *demela*, *harabela*, *kaçarruma*, *kavalla*, *kazana*, *këçmilla*, *kraha*, *krepa* (= akrepë), *lishâna*, *naplona*, *patllexhana*, *plepa*, *pulluma*, *qepena*, *qypa*, *rrapa*, *saça*, *skepa*, *specpa*, *tasa*, *thelba*.

(b) *burima*, *gardha*, *grushta*, *haliça*, *kopshta*, *lena*, *livadha*, *mala*, *maza*, *mulukata*, *plisa*, *pusa*, *qarra*, *qina*, *rrjeshta*, *toça*, *trapa*, *vena* (= vende), *vidha*, *xektha*.

(c) *drapna*, *gjarpna*, *gjishta*, *la^oma*, *shkopa*, *luma*, *prifta*.

(ç) *kapërcella*, *këriklla*, *mashklla*, *portokalla*, *turtlla*, *lepra*.

(d) *akllaja*, *frehna*, *krâ^ohna*.

Denduria e shumësave me *-a* është karakteristike për emrat mashkullorë, por kemi takuar edhe pak emra femërorë që në shumë marrin të njëjtën mbaresë, si: *dama^ota*, *degafërmija*, *ftuja*, *gërrâ^ona*, *patata*, *vorba*. Me *-a* del

edhe shumësi i emrit *hoxh* (=hoxha), që lakohet sipas paradigmës së emrave femërorë.

Gjithashtu mbaresa *-a* e shumësit ka një shtrirje të madhe edhe në disa emra të tjerë si mjet formëformues i mbishtuar, si: *kalamaja*, që është mjaft i përhapur në Tiranë.

2. Ndër emra mashkullorë përhapje ka edhe shumësi me ndërrim të kuantitetit të zanores së theksuar. Në këtë rast kemi gjatësi kompensatore si kompensim të rënies së mbaresës *-ë* të shumësit. Kjo mënyrë e formimit të shumësit është karakteristike sidomos për emrat që sosin në temë më *-k*: *axhāk, bardhāk, batūk, berék çakmāk, dajāk, demlék, dyshék, furrik, fyshék, jatāk, jestik, kushāk, malōk, patōg, qerpik, rosāk, sēnyk, shōk, ullūk, xhelék* (krahaso njëjësit *axhak, bardhak, batuk* etj.). Me të tillë trajtë dalin në shumës edhe shumë emra, që sosin në temë me një bashkëtingëllore tjetër: *kapūç, puli:ç, sāç, carāc, karcalēc, kathēc; çerjēp, dallāp, skēp; dhām; hajvān; uri:q; rrallōsh; demēt*. Emrat që sosin në temë më /r/ dalin në njëjës dhe shumë njëlloj, zanorja e theksuar është e gjatë: *dëshmitār, gamōr, gūr, ltār, mullār, ushtār* etj.

3. Disa emra e formojnë shumësin me mbaresën *-na*: *barna, beharna, dellna, fjamurna, gardhna, hellna, lāˆmna, murna, pusna, pyllna, qeverrina, qillna, shina; rrëejna, gjaˆjna* (dy të fundit në analogji me *përrojna, krojna*).

4. Emrat që sosin në temë më /ll/ në të shumtën e rasteve e formojnë shumësin duke jotizuar këtë bashkëtingëllore në /j/: *būj, çakaj, hamaj, kaçmij, kaproj, karrikuj, kuuj, mashkuj, nipoj, trutuj, thënij* (ose *fëjij, fënij*), *vishkuj*.

5. E formojnë shumësin me palatalizimin e *k, g* të temës në *q, gj* (>q) emrat *botuk > botuq, bŭlk > bŭlq, lug > luq, mik > miq, plug > pluq, uk > uq, vark > varq*.

6. Mjaft dendur del shumësi me *-j* (<nj). Zakonisht mbaresën *-j* e marrin ata emra, që sosin në temë me një *-n* primare ose jo primare; e marrin këtë mbaresë, në mënyrë analogjike, edhe disa emra të tjerë që nuk dalin në temë më *-n*: *brīj, drīj, gjūj, hūj, hutīj, kacabūj, kallīj, kërcūj, kërhāˆj, mëttīj, pulastrēj, shelqīj, shpërgāˆj, ullīj, zejīj, zgjoj, mij, kroj, përroj, vargoj*.

7. Disa emra mashkullorë e formojnë shumësin me metafoni: *cap > cep* (= *sjep*), *dac > dec, dash > desh, gugash > guges, mëzat > mëzet, shjarth > shjerth*.

8. Shumë emra e formojnë shumësin me dy ose më shumë mjete gramatikore: disa palatalizojnë *ll*-në e temës në *-j* dhe marrin mbaresën *-a* ose *-e*: *yja* (S., K., M.); *pyja* (S., K.) edhe *pyje* (K.); *troja* (S., K.); *hoja* (S.), por edhe *hoje* (S., M.); *shoja* (S.). Ndonjë ndërron *ll* në *j* edhe zanoren e temës: *kapcyll > kapcej* (S., K., M.). Me mbaresat *-j* dhe *-na* ose *a* e formojnë shumësin emrat *krojna, prrojna* (në të gjitha pikat), *vajna* (M.), *kalamaja*. Ka raste kur palatalizohen grykoret *k, g* të temës dhe shtohet mbaresa *-e*: *tork > torqe* (S.); *varg > vargie* (S., M.); *shtek > shteqe* (M), por edhe *shteqa* (M.), në S. *shtiqe* (shumës me tri mjete gramatikore). Mund të palatalizohet *k* dhe të

ndërrojë një zanore e temës: *shkop* > *shqep* (S., M., K.), *çark* > *çerq*, ose krahas palatazimit të *k*-së kemi edhe zgjatjen e zanores së theksuar: *jatak* > *jatāq* (S.); *jastik* > *jesti:q* (M.). Ndonjë emër e formon shumësin me ndërrim të ndonjë zanoreje të temës dhe me mbaresën *-ën*, (*-n*): *shtrat* > *shtretën*, *shāt* > *shytën*, *tra* > *trën*. Interes paraqesin shumësat *kallës* (= kallinj), *specas* (= specat), *kol*, *vllazën*, *mështjerr* (për viçat, S.), *djel* (S.), ose *djelm* (K.), *praq* (M. njëjës *pratk*), por *pratje* (K., njëjës *pratk*), *turti* (për *turtuj*, K.).

Disa emra dalin në shumës njëjloj si në njëjës: *krahe*, *këçmill*, *drapën*, *gjarpën*, *trajull* (M.).

Trajta dhe rasat

Rasa emërore

1. Emrat mashkullorë, që në shumë të folme dalin në temë më *-h* ose *-hën*, marrin zakonisht një /e/ pas grykores *-h*: *ahe*, *frêhe*, *krahe*, *qêhe*, *rrahe*, *strehe*. Këto janë format më të rëndomta në Ndroq e Pezë.

Kur shquhen, këta emra e bjerrin zanoren *-e* dhe marrin njëjën e prapme *-i*: *ahi*, *frêhi*, *krahi*, *qêhi*, *rrahi* etj., por në këto të folme shpesh takohen edhe trajtat me *-hën*, si: *plêhën*, *krâhën*, *frêhën*. Ndërkaq trajtat e shquara gjegjëse *krâhni*, *frêhni* takohen më rrallë se *krâhi*, *frêhi*.

2. Më *-e* sosin në temë edhe disa emra femërorë: *basmë*, *grihe*, *gjuhe*, *kohe*. Kur shquhen këta emra bjerrin zanoren /e/ dhe para njëjës *a* marrin një *-j*-epentetike: *basmja*, *grihja*, *kohja*.

Përkundrazi, një grup tjetër emrash femërorë, që në shumë të folme dalin në temë më *-e*, në këtë të folme nuk e kanë këtë zanore fundore: *çêrdh*, *domât*, *mâc*, *patât*, *vôrb*. Në trajtë të shquara këta emra marrin drejtëpërsëdrejti njëjën *-a*: *maca*, *patata*, *vorba* dhe më rrallë e marrin njëjën *-a* nëpërmjet një *-j*-epentetike (*çerdhja*).

3. Emrat që në emëroren e pashquar dalin më *û* (e prejardhur nga monoftongimi i *ue*-së), kur shquhen rinxjerrin zanoren /o/ të pazbërthyer, së cilës i shtohet nyja e prapme *-i*, që dëgjohet si gjysmëzanore (*i*): *ftû* > *ftoi*, *krû* > *kroi*, *paktû* > *paktoi*, *përrû* > *përroi*, *vargû* > *vargoj*, *zjû* > *zjoj*. Njëjloj e formon trajtën e shquar edhe *thû* > *thoi*, (zanorja e theksuar është gojore); në S. ndeshëm edhe *droj* (=druni), që duket qartë se është formim analogjik. Në një toponim (S.) kemi dëgjuar edhe trajtën e shquar me diftong të monoftonguar: *ke Krûj*.

4. Në Pezë e në pjesën më të madhe të Ndroqit emrat që në emëroren e e pashquar dalin më *ûr*, *ûll* (< *uer*, *uell*), kur shquhen rinxjerrin zanoren *o* të pazbërthyer edhe marrin njëjën e prapme *-i*: *frûr* > *frori*, *kallnûr* > *kallnori*, *krahnûr* > *karahnori*, *kaprûll* > *kaprolli*, *plûr* > *plori*, *qershûr* > *qershori*, *trûll* > *trolli*. Në S. zanorja e theksuar e temës *o* diftongohet jo vetëm në trajtën e pashquar, por edhe në të shquarën: *frûr* > *fruri*, *kallnûr* > *kallnuri*, *krahanûr* >

krahanuri, pjūr > pkuri, qeshūr > qeshuri; por shpūr > shpori.

5. Emrat mashkullorë që sot mbarojnë me një zanore hundore, meqenëse e kanë humbur *-n* fundore, në trajtë të shquar e rinxjerrin atë; njëlloj e formojnë trajtën e shquar edhe disa emra të tjerë që sonoren /n/ dhe hundorësinë e kanë përfutuar në analogji: *brîni, gjûni, hîni, hutîni, kacabûni, kallîni, kërcûni, mullîni, mutîni, pêni, shullâ°ni, ullîni, xhapîni*. Emri *qingj*, që del në trajtën e pashquar *qî*, shquhet duke marrë nyjën *-u*: *qîu*, e cila është forma e vetme në Ndroq e Pezë.

Rasa kallëzore

1. Forma më e përgjithshme e kallëzores së shquar, që është karakteristike për këtë të folme, ndërtohet me mbaresë-nyjën *-n*, para së cilës del zanorja epentetike *i/u*: *ballin, barin, burrin, dashin, hararin, koshtin, krahin, katunin, kularin, plumin, telin, zallin, gjakun, hakun, plakun, mikun, bregun*.

2. Ka raste kur në format e kallëzores nuk vihet re ndonjë zanore epentetike para maresë-nyjës. Forma të tilla konstatohen në rastet: (a) Mbaresë-nyja *-n* i shtohet drejtpërsëdrejti emrave, që sosin në temë më zanore të theksuar, e cila mund të jetë përfutuar edhe nga monoftongimi i një diftongu, si: *ben, efenin, furxhîn, kân, kryzîn, mîn, parrûn, qîn, sÿn, shîn, Shyqyrin, thûn, vân, vllân, zjûn*. Ja disa shembuj në kontekst: e thera *kân* (M.), ka bâ *qîu qîn* (M.), (= ka pjellë qengji qengjin), me Beqir *Ben* (M.), e vûna *zjûn* (S.), vrava *sÿn* (K.), po e deshe *efenîn* (K.); (b) Nuk del asnjë zanore para mbaresë-nyjës në rastin kur emri sos në temë më një bashkëtingëllore hundore, e cila asimilohet me mbaresë-nyjën; zanorja e theksuar herë dëgjohet e gjatë e herë e shkurtër. Shembuj: e merr *çûn* / qi gjet n`xhami (K.), *çun* e mrasëm e martoj (K.), do ta vë *dohôn* (K.), ja hek *kallin* (M.), Shyqyriu me *Osmân*, prishe ramazân (K.), i merr *kallin* (S.), kërkoshe *Nastradîn* (S.), e nîn *qen* (S.), vret *qên* (S.), t`kep *mullî:n* (S.).

Krahas këtyre, dëgjohen edhe format me zanoren epentetike /i/ midis temës dhe mbaresë-nyjës: *çunin, pjâ°nin, grunin, frênin, zâ°nin*. Së fundi, marrin drejtpërsëdrejti *-n* edhe pak emra, që sosin me bashkëtingëllore të tjera; forma të tilla dëgjohen rrallë: tue narkû *gomârñ* (K.), *tellâlln* (M.), *kûjn* (M.), *ujn* (S.).

Rasa vendore

Në këtë të folme përdoret gjërësisht e ashtuquajtura 'rasë vendore'. Kjo formë shoqërohet kryesisht me parafjalët *m* (<*më*), *n* (<*në*), që tregojnë marrëdhënie vendore e kohore, gjithashtu edhe me parafjalën *me* që tregon marrëdhënie shoqërimi, mjeti e mënyre: rrîn gjâ°t *m'hijet* (S.), pe e fusim *m'harârt* (S.), na kapi *n'qafët* (S.), kaj hër *n'javvët* (S.), i kâl *me nuset* / i kâl *me pajt* (M.), ishte lith *me t'vllât* (M.), vetëm dulëm *m'shkomt* (M.), ene shkoj ra *me grût* (K.), jam tue nja *me plukt* (ose *me përmenët* (K.)), e kishin pas vër

m'kujt (K.), gjarpni i ban këlyshët nalt *n'pemët* (K.).

Për përdorim të gjerë të kësaj forme flet edhe fakti se emri i shqëruar me parafjalët e vendores në togfjalësh me atribut (një mbiemër i nyjshëm ose një emër në gjinore), del më shpesh në formën e vendors sesa në kallëzore të pashquar; e kundërta ndodh p.sh. në të folmen e Krujës⁷: i kena *kâ n'lagjet sipme* (M.), *m'kohet* Turqijes ushtaret u kan pas thān asqer (M.), kishte njet i ashkel *m'çyçt* apejës (S.), *m'Brekt Xânës* (S.), *m'rrëket* matanshme (K.), t'râft i pūshk *n'lulet* ballit (K.), na m'at koh *m'gjurmët* kalit kemi pi uj (K.).

Nyja *-t* u shtohet pandërmjetshëm emrave që sosin në temë më zanore (që mund të jetë përfutur edhe nga monoftongimi i një diftongu), emrave që kanë pasë sosur me një *-ë* fundore të patheksuar dhe, së fundi, emrave tema e të cilëve sos më një bashkëtingëllore të vetme: dil aty *m'vāt* (M.), t'marri pak vāl *me çorbët* (M.), e presin *n'derët* (S.), m'ka ra i gjem *m'thūt* (S.), fut gjelin *n'kosht* (K.), ra *m'pust* ai (K.).

Nyja *-t* shtohet jo drejtpërsëdrejti, po nëpërmjet zanoreve lidhëse *i*, *u*, kur tema e emrit sos me dy bashkëtingëllore; zanorja lidhëse *u* përdoret kur bashkëtingëllorja e dytë është grykore, ndërsa *i* kur ndodhet një bashkëtingëllore çfarëdo: ai me shkopt shukojte *m'hisllit* (K.), sa vët qēt *n'misrit?* (K.); merri çoj psi *n'bulkut* (K.), ai patnej *n'burgut* (M.). Në ndonjë rast zanorja lidhëse del edhe pas një teme që sos me bashkëtingëlloren *-h*: *m'krahit murrā°nit* (S.).

Rasa gjinore, dhanore e rrjedhore shumë

Emrat mashkullorë dhe femërorë në gjinore, dhanore e rrjedhore dalin në të shumtën e rasteve me mbaresën /e/. Këtë mbaresë marrin, në radhë të parë, emrat që në emërore shumë dalin në bashkëtingëllore: u kam ra paktojt *kolet* mij (K.), ky aty hallakatet ene u gërthet *vllaznet* (K.), m'ōd *miqet* (S.), paret *e fiqet* (S.). Mbaresën *e* e marrin në format rasore të mësipërme emrat femërorë që sosin në temë më *-ë*, e cila ka rënë: m'krýt pesmdhit *dite* (K.), t'i bjeri vrugu *qepet* (K.), qiçim qilet *e pushket* me lopāt (M.), *lopet* mija u ka hec mār (M.), dulën *faret* (S.), n'krýt dy *ditet* (S.). Së fundi, mbaresën rasore /e/ e marrin edhe emrat mashkullorë që e formojnë shumësin me mbaresat /ë/ dhe /a/ dhe që i bjerrin këto në gjinore, dhanore, rrjedhore shumë: *dasmoret* ju thōt (K.), pse i ke thër lopët *antaret* (K.), s'ma majti mu t' i bzāj *robet* mi (M.), m'kohet turqijes *ushtaret* u kan pas thān asqer (M.), harxha *hajvanet* (S.), pushkën e *xhendaret* (S.), nejn e *gjishtet* (K.), i kishte thā:n *çunet* (M.).

Mbaresa *-ve* përdoret atëherë kur emrat mbarojnë me zanore të theksuar në emërore shumë: u qelpte veni prej mishit *baktive* (M.), zjedha *e qevet* (S.); futi t'hān *dhivet* (K.). Shumë rrallë *-ve* takohet edhe në raste kur në këtë të folme pritej *-e*: Kodra *Berrvet* (M.), *pulvet* (S.).

⁷ J. Gjinari, "Vëzhgime mbi të folmen e Krujës", *Studime filologjike*, nr. 4/1964, f. 118.

Mbaresën rasore /e/ e gjejmë gjithashtu edhe tek toponimet e dalë nga patronimikat, d.m.th. në emërtimet e vendeve sipas fiseve: Mhalla *Liljet* (K.), Mhalla *Shimjet* (K.), Çesmja *Trimjet* (K.), Djerrri *Taffjet* (K.), Gryka *Koljet* (K.), Qafa *Zymjet* (M.), Qafa *Koljet* (M.), Krün e *Abazjet* (M.). Bashkëtingëllorja -j, që gjindet pothuajse rregullisht para mbaresës rasore -e, besojmë të jetë elementi i dytë i prapashtesës -aj me të cilën janë formuar patronimikat. Nuk mund të shihet j-ja si tingull epentetik se përndryshe ajo nuk do të shfaqej në toponimet e dala nga patronimikat.

Nyja

Interes dialektor paraqit nyja joshquese *nji*. Kjo fjalë kur kryen funksionin e nyjës del në variantet fonetike *ij*. Në /j/ nyja *nj* kalon nëpërmjet *i*, sa herë që kjo e fundit bashkëshqiptohet me një fjalë tjetër paraprijëse atone. Shembuj: preva *i* dru t'math (S.), bjeva *i* pāl krahâ°j leshi (S.), mu ka zotū *i* mik (K.), qajte *i* kalama (K.), e do *i* çap būk (M.), nejm *i* cōp hēr m'ato hije rrapash (M.), i shkon *kaj* zok n'ditēt (S.) i futshin dy dūrt *mej* kutī: (S.), dy vēt *mej* men nuk qekshin (K.), *mij* krahe m'qit djathin / *mij* krahe tēlynt (K.), i djāl *ej* gōc ka me grūn e dŷt (M.).

Fjala *nji*, kur luan rolin e një përemri, del në variante të tjera fonetike (shih më poshtë).

Përemrat

Përemri vetor

Forma kryesore e vetës së parë njëjës është *un*; në S. përdoret rrallë edhe *una*. Për vetën e I-rë shumës rasi emërore e kallëzore përdoret rregullisht *na*; ndonjëherë të zë veshi edhe *neve*, *ne*. Trajta e dhanores është *neve*.

Përemri e mbiemri dëftor

Njëjësi femëror del në zanore në trajtën *qo* dhe *kjo*, të cilat përdoren që të dyja dendur. Përemri dëftor i rasës emërore njëjës i gjinisë mashkullore del vetëm në trajtën *ky*. Ky përemër, kur shërben si përemër-emër, në rasën kallëzore del në trajtën *kte*: a punohet me *kte* (K.), sall *kte* kena (M.), *kte* e gallxojn / *kte* e kam pas ni prej t'vjetrish (M.); ndërsa kur shërben si përemër-mbiemër në rasën kallëzore përdoret në trajtën *kët*: a t'la *kët* kosh (S.), i gjeta *kto* me *kët* fjal (M.), ma ka lān baba *kët* shēj (K.), maī *kët* mūr (K.).

Shumësi mashkullore e femëror del në emërore në trajtën *kto* (një shtrirje e formës së femërores edhe për mashkulloren). Rrjedhorja shumës për të dyja gjinitë është *ksi*: *ksi* gjājnash (K.), *ksi* miqsh (M.). Po kështu edhe forma e rasës rrjedhore e përemrit *ai*, *ajo* për të dyja gjinitë është *aci*; *aci* vakti nuk shkojshim (K.), mos na ban *aci* punsh (M.).

Përemri e mbiemri pronor

1. Përemrat pronorë të vetës së parë e të dytë, prona e pronari njëjës, kanë njëj të përparme: *i imi, e imja, i joti, e jotja*; kur përdoren si përemra-mbiemra, nyja e përparme mungon rregullisht: *kali im, lopa ime, kali jot, lopa jote*.

Edhe në shumës përemrat pronorë të këtyre dy vetave kanë njëj të përparme; *i joni, e jonja, i juj (i juve), e juj (e juve)*. Pa nyja dalin kur përdoren si mbiemra: *kali jon, lopa jon, kali juj (kali juve), lopa juj (lopa juve)*.

2. Si në të folmet e Peqinit e të Kavajës, edhe këtu përemri vetor i rasës gjinore veta e dytë shumës *i juve / e juve* zëvendëson herë-herë përemrin-mbiemër pronor në vetën II-të, pronari shumës, prona njëjës e shumës: *kali juve, kolte juve, lopa juve, lopte juve* etj. (Shih tabelën përmbledhëse të mbiemrave pronorë.)

3. Për sa i takon përemrave e mbiemrave pronorë nuk kemi konstatuar dallime midis pikave të ndryshme të banuara të Ndroqit dhe Pezës, të cilat në këtë pikë janë mjaft unike. Vetëm në K. takohen rrallë herë *tim, time* krahas *tem, teme*. Po shtojmë gjithashtu se dallimet midis pronorëve në Ndroq-Pezë dhe të pronorëve që dëgjohen në Peqin, janë fare të pakta: kështu, për rasën emërore, vet. I, prona dhe pronari njëjës, femëror e mashkullor, kemi takuar në Peqin dy forma *teme (ime)* dhe *yt (jot)*; në Ndroq e Pezë vetëm një formë e pikërisht *ime, jot*. Gjithashtu për rasat e zhdrejta, veta II, mashk. e femëror prona njëjës, pronari shumës, krahas formës *juve*, takohet kryesisht trajta *tuj*, ndërsa në Peqin, krahas *jive*, përdoret forma *juj*.

Tabelë përmbledhëse e mbiemrave pronorë

Rasa	Veta I		Veta II	
	M	F	M	F
Em.	<i>kali im</i>	<i>lopa ime</i>	<i>Kali jot</i>	<i>lopa jote</i>
GJ.Dh.	<i>kalit tem</i>	<i>lopës teme</i> (time)	<i>kalit tat</i>	<i>lopës tate</i>
Kall.	<i>kalin tem</i> (tim)	<i>lopën teme</i>	<i>kalin tat</i>	<i>lopën tate</i>
Em.	<i>kolt e mij</i>	<i>lopte mija</i>	<i>kolt tuḡ</i>	<i>lopte tuja</i>
GJ.Dh.	<i>kolet mij</i>	<i>lopet mija</i>	<i>kolet tuḡ</i>	<i>lopet tuja</i>
Kall.	<i>kolt e mij</i>	<i>lopte mija</i>	<i>kolt tuḡ</i>	<i>lopte tuja</i>
Em.	<i>kali jōn</i>	<i>lopa jōn</i>	<i>kali juḡ (juve)</i>	<i>lopa juḡ (juve)</i>
GJ.Dh.	<i>kalit tōn</i>	<i>lopës tōn</i>	<i>kalit tuḡ (juve)</i>	<i>lopës (tuḡ) (juve)</i>
Kall.	<i>kalin tōn</i>	<i>lopën tōn</i>	<i>kalin tuḡ (e juve)</i>	<i>lopën tuḡ (e juve)</i>
Em.	<i>kolt tōn</i>	<i>lopët tona</i>	<i>kolt tuḡ (e juve)</i>	<i>lopët e juve</i>
GJ.Dh.	<i>kolet tōn</i>	<i>lopet tona</i>	<i>kolet tuḡ (juve)</i>	<i>lopet juve</i>
Kall.	<i>kolt tōn</i>	<i>lopët tona</i>	<i>kolt tuḡ (e juve)</i>	<i>lopët e juve</i>
Veta III				
	Mash.		Fem.	
	Prona njëjës mashkullore	Prona njëjës femërore	Prona njëjës mashkullore	Prona njëjës femërore
Em.	<i>kali atij</i>	<i>lopa atij</i>	<i>kali asaj</i>	<i>lopa asaj</i>
GJ.Dh.	<i>kalit atij</i>	<i>lopës atij</i>	<i>kalit asaj</i>	<i>lopës asaj</i>
Kall.	<i>kalne atij</i>	<i>lopne atij</i>	<i>kalne asaj</i>	<i>lopne asaj</i>

Përemri e mbiemri i pakufishëm

Fjala *nji* si përemër i pakufishëm del në trajtën *în* si në rasën emërore ashtu edhe në kallëzore: *în* prej nesh ktu / paska për t'dal (S.), vrën *în* ktu m'katun (S.), kishte pas qëñ *în* (S.), m'ka ardh *în* a e ngjo (K.), ka majti *în* / s'majti *în* (M.).

Përemri-emër *nji* në trajtën e shquar del në formën *jâ°ni*: m'gjasi *jâ°ni* si B.Ç. / miku im (S.), *jâ°ni* / i pari / kishte marr kalin (S.), *jâ°nin* t'mash prej nesh (M.). Në K. kemi takuar edhe formën *îut* për rasën dhanore: *îut* i kishte hum gruja.

Fjala *nji* e reduktuar në *i*, kur shoqërohet me emër të shquar farefisnie, ka kuptimin 'njëri nga': *i* çuni xhait tem (S.), kam pas *i* dajën tem (K.), gjeç vetëm *i* katunarin tem (M.).

Dendur takohet edhe përemri i pakufishëm *nej* (=ndonjë), që është i përbërë nga *ne + j* (< *nji*): ka dash *nej* gōd (S.), du *nej* zarzavāt (S.), merr *nej* thes (K.), po t'nishim *nej* gjâ° ne atje (M.), ç'kina *nej* llafe (M.).

Interes kanë edhe përemrat e pakufishëm *kush*, *gjithsekushi*, *gjithsecilli*: i kishin pas çū / *kush* i pūl / *kush* i kaçile fiq (M.), *gjithsekushi* ka rrugne vet (K.), do u api rrūg *gjithsekujt* (S.), *gjithsecilli* do vegjlën e vet (K.).

Foljet

Mënyra dëftore

Koha e tashme

1. Foljet e zgjedhimit të tretë⁸ që dalin në temë më *-t*, e ndërrojnë këtë në /s/ në vetën e I-rë njëjës e shumës dhe në vetën e III-të shumës: *fus*, *godis*, *mys*, *kpusim*, *prashisim*, *qisin*, *vasin*.

2. Foljet me temë më bashkëtingëllore të tjera kanë mbaresë zero në njëjës: I *mjell*, *tun*; II *mjell*, *tun*; III *mjell*, *tun*. Këto folje në vetën e I-rë dhe të III-të shumës marrin përkatësisht mbaresat *-m*, *-n*; zakonisht ndërmjet temës dhe mbaresës del zanorja epentetike /i/: *shkunim*, *hekim*, *marrim*, *qeshin*, *përdurin*, *lidhin*, *nelin*.

3. Mbaretat vetore të foljeve të zgjedhimit të parë të të dyja klasave janë: njëjës: I *-j*, II (-) dhe *-n*, III (-) dhe *-n*: shembuj: veta I: *bâ°j*, *çpoj*, *gërmoj*, *kërkoj*, *ñarkoj*, *punoj*, *qëroj*, *shkoj*; vet. II: *bâ°*, *beso*, *dëshro*, *fërgo*, *kërko*, *kupto*, *msho*, *rrxo*, *shko*; por edhe *beson*, *shkon*, *man*; vet. III: *bâ°*, *beso*, *bështo*, *ço*, *frÿ*, *këno*, *kullo*, *msho*, *ma*, *ñarko*, *puno*, *shko*, *tako*. Krahas formave pa mbaresë kemi dëgjuar edhe format me mbaresë vetore: *beson*, *bështon*, *binon*, *dëften*, *duron*, *fleron*, *lshon*, *man*, *mén*, *ngjon*, *shtjen*. Për vetën e dytë dhe të

⁸ Sipas klasifikimit të Sh.Demirajt, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*.

tretë takohen shumë më shpesh format me mbaresë zero dhe rrallë ato me mbaresën *-n*, luhatje e theksuar vihet re te i njëjti subjekt.

Foljet *mbaj*, *pi* në vetën e II-të e të III-të dalin me mbaresë: *man*, *pin*: po kështu edhe ndonjë folje e parregullt si *han*, që edhe në vetën e parë del me mbaresë (*haj*); në këtë rast kjo e folme afron me të folme gege veriore.

4. Në shumës foljet *jam*, *kam*, *thom* zgjedhohen në disa forma, të cilat kanë një përhapje të gjerë. Një larmi e tillë formash shpjegohet kryesisht me ndikimin analogjik midis vetave: I *jemi*, *jena*, *jimi*, *jina*; II *jeni*, *jini*; III *jâ:n*; I *kena*, *kimi*, *kemi*, *kina*; II *kini*, *keni*; III *kan*; I *thena*, *thona*, *themi*; II *thoni*, III *thôn*.

Koha e pakryer

Format e tri vetave njëjës sajohen kryesisht me mbaresa: I *-she*, *-jshe*; II *-she*, *-jshe*; III *-te*, *-jte*. Mbaretat I *-she*, II *-she*, III *-te* i marrin foljet që dalin në temë më bashkëtingëllore: I *hikshe*, *huthshe*, *kapshe*, *merrshe*, *shifshe*; II *kapshe*, *huthshe*, *lakshe*, *merrshe*, *shifshe*; III *dilte*, *kapte*, *kallte*, *qiste*, *merrte*, *gryste*. Mbaretat I *-jshe*, II *-jshe*, III *-jte* i marrin foljet që dalin në temë më zanore: I *blejshe*, *dijshe*, *hajshe*, *kthejshe*, *gjujshe*, *shÿjshe*, *shlojshe*, *shkojshe*, *vÿjshe*; II *blejshe*, *flejshe*, *gjujshe*, *hajshe*, *kthejshe*, *shkojshe*, *shÿjshe*; III *bâ'jte*, *blejte*, *dojte*, *gjujte*, *lujte*, *nalojte*, *ÿrejte*, *shajte*. Siç shihet, format e vetës së parë dhe të dytë njëjës janë të njëjta.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për format e shumës: marrin mbaretat *-shim*, *-shi*, *-shin* foljet që dalin në temë më bashkëtingëllore: I *kapshim*, *merrshim*, *pritshim*; II *kapshi*, *merrshi*, *pritshi*; III *kapshin*, *merrshin*, *shtypshin*. Ndërsa foljet që dalin në temë më zanore marrin mbaretat: I *-jshim*, II *-jshi*, III *-jshin*: I *blejshim*, *flejshim*, *kthejshim*, *zÿjshim*; II *blejshi*, *flÿjshi*, *gjujshi*, *hajshi*; III *gjujshin*, *hajshin*, *kthejshin*. Përveç mbaresave të mësipërme që takohen më shpesh në të gjitha pikat e banuara, fare rrallë ndeshen edhe këto mbaresa: *-sha*, *-jsha* (M.) edhe *-je* (K.) për vetën e I njëjës, *-nte* për vetën e III njëjës te foljet që sosin në temë më zanore (sidomos në M.): *dinte*, *dante*, *martonte*, *runte*. Gjithashtu përdoren më shpesh mbaretat *-she*, *-te*, *-shim*, *-shin* (në vend të *-jshe*, *-jte* etj.) te foljet që sosin në temë më zanoren /i/: *shtishe*, *pishe*; *bite*, *shtite*, *vÿte*; *bishim*, *dishim*, *vÿshim*; *shtishin*, *pishin*, *vÿshin*. Në S. dhe K. takohen fort rrallë mbaretat *-jim*, *-jit*, *-jin*, ose variantet e tyre fonetike: *im*, *in*: *bijim*, *blujim*, *biin*, *bâin*, *bluin*, *shtiin*. Për sa i përket formave të së pakryerës konstatohet një uniformitet për të gjitha pikat e banuara.

Koha e kryer e thjeshtë

Foljet që dalin në temë më *-ol(l)*, *-or(r)* dhe që zanoren e theksuar të temës e kanë të diftonguar, në vetën III njëjës kanë mbaresë zero: *dÿl*, *mshtÿll*, *pÿll*, *sÿll*, *mÿr*, *nxÿrr*.

Mbaretë zero marrin në këtë vetë edhe disa folje që sosin në temë më një

bashkëtingëllore tjetër: *erth, gjet, hoq, toq, nej* (në S. *nejt*).

Foljet që dalin në temë më /o/ marrin mbaresën *i*, një gjysmëzanore e ardhur nga *-i*: *çoj, kërkoi, shkoj, shtektoj*. Në të folmen e Ndroqit dhe Pezës takohen mjaft shpesh, shumë më shpesh sesa në të folmen e Elbasanit, format e aoristit sigmatik: *erthsh, gjeç, paç*; sidomos në formën pësore. Folja *humb* në S. vet.III njëjës dëgjohet në trajtën *humati*.

Mbaresat e shumësit janë këto: I *-m*, II *-t*, III *-n*. Në disa raste jo aq të rralla, përpara këtyre mbaresave, nuk dëgjohet *ë*-ja anapitike: *dūlm, erdhm, fjetm, murm; dūlt, ertht; dūln, gjetn, patn, vdiqn, zdrypn*.

Koha e ardhshme

Njëra nga format kryesore të së ardhshmes në këtë të folme ndërtohet nga folja ndihmëse *do + lidhore e tashme*. Në shqiptim të ngërthyer shumë herë pjesëza *të* e lidhores pasi reduktohet në *t* (kjo ndodh kur nuk pasohet nga përemri i trajtës së shkurtër *e*) bashkëshqiptohet me pjesëzën *do*: *dot pys* për i gjâ° un ty (K.), *dot na bīn* (M.), *dot vi ne un* (S.), *dot bâ°j i shpi* (S.). Në raste të tjera /t/ nuk dëgjohet fare: *mos u mērzit se do vīj i koh* (K.), *do kena* (M.), *do laksh* (M.), *do dahna vēt* (S.).

Një tjetër formë kryesore e së ardhmes është edhe ajo që sajohet nga ndihmëtarja *kam* me paskajoren perifraztike me pjesëzën parafjalore *për*. Kjo formë e së ardhmes, megjithëse takohet mjaft shpesh, zë vendin e dytë pas formës së mësipërme, shembuj: *kam për t'shku* vet (S.), *ke për t'qit* këtë lajm ti sot (M.); *ke un s'ka për t'ardh* jeri (K.), *dot na kërkoni mej koh / po s'keni për t'na gjet* (K.), *ke për t'u habit* kur t'shkosh nesër n'Matere (K.).

Ndihmëtarja *kam* e kësaj forme analitike mund të ndodhet edhe pas foljes themelore: *ju për ta kap keni* kte (K.) *aj për ta marr ka* (M.). Këto shprehin një veprim që do të ndodhë në të ardhmen me siguri, mundet që midis dy komponentëve të formës analitike të kallen gjymtyrë të tjera të fjalisë: kur *kam nej fik, nej rrush për t'çū* (S.).

Rrallë takohet edhe forma tjetër analitike e së ardhmes që sajohet nga ndihmëtarja *kam + paskajore gege*: nuk *ka me e shti* pasunin goca n'dyshekt / po do djalin (K.); se t'rrëxohesh / *ke me e kujtū* Ramazan Trimin ti (K.), nuk *ke me gjet* (K.), *ka me e sha* psi (S.).

Kohët e përbëra të dyta

Në Ndroq e Pezë kemi takuar edhe dy format kohore të përbëra:

1. E kryera e dytë e m. dëftore e formuar nga e kryera e foljes *kam + pjesore* e foljes themelore: hejrët *ka pas qēn* kshu mre la (S.), *m'ka pas gallxū* (S.); *e kan pas pērdūr* leshin (K.), apeja bulli *kemi pas vesh* (K.); *e kena pas mjēll* mār me pērmēn (M.), grāt *kan pas vesh* dimit / basmi // burrat *kan pas vesh* xhōk (M.).

2. E kryera e plotë e dytë formohet nga e kryera e plotë e foljes *kam +*

pjesore e foljes themelore: *e kisin pas vār m'kûjt* (K.), ai tagān *e kishte pas kap / ene i bi m'tagant ta presi* (K.), *i kishin pas çū / kush i pūl / kush i kaçile fiq* (M.), *kishte pas qēn î:n...* (S.).

Format pësore të dëftores

1. Në tri vetat e njëjësit të kohës së tashme foljet kanë këto mbaresa: I *-na, -mi*; II *-e*; III *-et*. Për vetën e parë në të gjitha pikat e banuara, më shpesh takohen format më mbaresën *-na*. Konstatohet se mbaresat *-na* dhe *-mi* të vet. së parë në të shumtën e rasteve nuk përdoren paralelisht te i njëjti subjekt, por zakonisht disa përdorin formën me *-na*, disa të tjerë atë me *-mi*. Mbaresat e mësipërme u prapashtohen foljeve të të gjitha zgjedhimeve; foljet që dalin në temë më zanore, marrin midis temës dhe mbaresave elementin epentetik /h/, shembuj: I *çuditna, krifna, mshtetna, mërzitna, ûlna, varna, hahna, lahna, kthehna, ɳrehna, zîhna, krifmi, llafosmi, lahmi, menohmi*; II *lodhe, krife; lahe, hahe*; III *krifet, lodhet, bâhet, lahet, krifet, zîhet*.

Në vetën e I-rë, të II-të e të III-të shumës të së tashmes foljet marrin këto mbaresa: I *-na, -mi*; II *-i, -ni*; III *-en*. Sikurse në njëjës, ashtu edhe në shumësin e foljeve që dalin në temë më zanore, midis temës dhe mbaresës del *h*-ja epentetike. Siç shihet, mbaresat e vet I nj. e sh. janë të njëjta. Shënimet që dhamë për përdorimin e këtyre mbaresave në njëjës vlejné edhe për shumësin: *krifna, lagna, mështetna, piqna, varna; lahna, hahna, pîhna, zîhna; lodhmi, mshtetmi, dahmi, lahmi, hahmi*. Për vet. II kemi gjithashtu dy mbaresa *-i, -ni*, por *-i*-ja ka një shtrirje më të gjerë: *krifi, mështetti, ûli; lahi, hahi, qahi, zîhi; hahni, lahni*. Shembuj për vet. III: *mështeten, ûlen; lahen, hahen, nërrohen, qahen, zîhen*. Shtojmë se elementi epentetik *-h-* dëgjohe mirë në të gjitha rastet.

2. Format pësore të së pakryerës sajohen rregullisht në këtë mënyrë: pjesëza përemërore /u/ u paraprin formave të së pakryerës veprore. Kjo është forma e vetme që takohet në Ndroq e Pezë; Njëjës I: *u bâ°jshe, u kthejshe, u lajshe, u zîjshe; u mshtetshe*; II *u kthejshe, u lajshe, u zîjshe*; III *u bâ°jte, u dajte, u gjinte, u hajte, u lajte; u hapte u merrte, u qelpte*. Shumës: I *u kthejshim, u lajshim, u zîjshim*; II *u kthejshi, u lajshi, u zîjshi*; III *u hajshin, u çojshin, u hajshin, u kthejshin, u lajshin, u kapshin, u puqshin, u vritshin*.

3. Në të kryrën e thjeshtë foljet e formojné formën pësore të vet. së parë nj. me anën e pjesëzës *u* dhe mbaresën *-sh*. Sikurse në të folmet tjera të kësaj treve Kavajë, Petrelë, Peqin, Prezë, edhe në Ndroq e Pezë përdoret mjaft aoristi sigmatik; disa shembuj për aoristin e foljeve me temë më zanore: *u bâ°sh, u fâ°sh, u gujtush, u kthysh* (ose *u kthesh*, S.), *u kuptush, u menush, u nërrush, u ɳresh, u penush, u pîsh, u shkrush, u ulsh, u zûsh*; për aoristin e foljeve me temë më bashkëtingëllore: *u çyryksh, u djersifsh, u lagsh, u lithsh, u lothsh, u përgjegjsh, u poqsh* (u puqsh), *u qellësh*, kur ndeshet *t*-ja e temës me mbaresën *-sh* përftohet mbaresa *-ç*: *u çudiç, u fuç, u rriç*.

E tashmja e mënyrës lidhore

Foljet që dalin në temë më bashkëtingëllore marrin në vet. II nj. mbaresën -sh: *t'apsh, t'dalsh, t'folsh, t'heksh, t'herrsh, t'hiksh, t'huthsh, t'iksh, t'jofsh, ta korrsh, t'lithsh, t'mjellsh, t'northsh, t'nylsh, t'shofsh, t'shkulsh, t'zjethsh*. Foljet e zgjedhimit III kanë në vet. II mbaresën -ç, e cila është përfutur nga shkrija e t-së së temës me mbaresën -sh: *t'grabiç, t'kpuç, t'kulloç, t'njáč, t'prashiç, ta qiç (= ta qitësh), t'rriç, t'zbuç*.

Format e mësipërme pa zanore epentetike janë të zakonshmet. Vetëm një numër i kufizuar rastesh kanë forma më /ë/ epentetike: *t'folësh, t'japësh, t'korrësh, t'therësh, t'veshësh (K.), ta mjellësh (S.), t'lëvizësh (M.)*. Këto janë gjithë rastet që kemi dëgjuar, madje edhe këto janë të lëkundshme. Shumica e tyre janë dëgjuar në K.

Foljet e zgjedhimit të parë marrin gjithashtu mbaresën -sh, para së cilës del, në shumicën e rasteve, bashkëtingëllorja -j e kohës së tashme: *t'bâ'jsh, t'besojsh, t'niysh, t'çojsh, t'kërkojsh, t'punojsh, t'qënrojsh, t'qërojsh, t'shajsh, t'shkojsh* etj. Dëgjohej -j përpara mbaresës, sidomos te foljet që sosin në temë më *o*. Krahas këtyre formave të rëndomta, dëgjohej jo rrallë edhe forma pa -j, kryesisht janë foljet që sosin në temë më zanore *u, i, a*, përfshirë ndonjë folje të parregullt, por nuk mund të lihen këtu më një anë edhe luhatjet që vërehen te foljet me -o: *t'dūsh, t'thūsh, t'pagūsh, t'bīsh, t'rrīsh, t'dīsh, t'vī:sh, t'gjī:sh; t'mash, t'thāsh, t'hāsh, t'zāsh, t'lāsh, t'hūsh, t'krūsh, t'kërkosh,, t'harrosh, t'çosh*.

Forma e vetës së tretë nj. e foljeve që u mbaron tema më bashkëtingëllore zakonisht ka mbaresën -i: *t'dali, t'fusi, t'heqi, t'marri, t'mushi, t'përmjerri, t'shkeli*; po edhe foljet e parregullta konsonantike; *t'api, t'bjeri, t'shofi*. Në ndonjë rast kjo formë është dëgjuar me mbaresë zero: *t'kullōs*. Forma e foljeve me temë në zanore ka mbaresën -j: *t'pejoj, t'shkoj, t'besoj*; mbarosa -j herëherë ka evoluar në -j: *t'blej, t'rrij* etj.

Mënyra urdhërore

1. Mbarosa -ni e shumësit, kur pasohet nga përemri *e* i trajtës së shkurtër, pëson ndryshime fonetike; elementi i dytë i kësaj morfeme shkrihet me të parin e si rezultat përfutet bashkëtingëllorja palatale *nj*. Ndërkaq përemri *e* në shumicën e rasteve nuk pëson ndonjë ndërrim fonetik: *funje, hanje, lanje, lidhnje, merrnje, myllnje*; por në M. dhe disa herë në K., ndeshen forma, kur përemri enklitik në rrugë analogjike kalon në -a: *hanja, lanja, merrnja, nijnja, pinja*. Format e fundit janë të rëndomta edhe në Kavajë.

2. Foljet e të gjitha zgjedhimeve formën pësore të vet. II nj. e formojnë duke marrë pas temës pjesëzën *u*; kur tema sos më zanore, del -h- ja për kundërhiatit: *nalu, krifu, varu; lahu, ruhu*. Si në të gjithë shqipen, pjesëza *u* paraprin foljen kur para kësaj përdoret pjesëza *mos*: *mos u krif, mos u nal*.

Vet. II shumë e formës pësore zakonisht ndërtohet me mbaresën *-i*, para së cilës del epentetikja *h*, kur foljet sosin në temë më zanore: *afrohi, kthehi, lahi*. Pjesëza *u* nuk del midis temës dhe mbaresës *-i* në foljet që sosin në temë më bashkëtingëlloire: *ûli, vari, krifî* (për *uluni, krifuni*).

Për vet. II nj., krahas formës *ja* (urdhërore e foljes *vij*), kemi takuar në S. edhe formën *jak*, që mund të jetë një kontaminim i *ja ka, jak* shpejt (=ja ka shpejt).

Mënyra habitore

1. Elementi kam i formës së të tashmes mënyra habitore në M., K. vet. I dhe e II nj. si dhe vet. I shumë del në format *paça, paçim*: *paça harrû un K.= paskam harue*, *ku paça qën thû* (K. = *paskam qenë*), *Pineti paça harrû M.= paskam harrue*, *ku pace qën qy ime* (K.= *paske qenë*). Formën e shumësit *paçim* e kemi dëgjuar të përdoret edhe si kohë e thjeshtë: *paçim nej sahat ej çerek* (M.= *paskemi*).

2. Folja *jam* në tri vetat e shumësit të kohës së tashme del në format: I *qekshim*, II *qekshi*, III *qekshin*. Në M. kemi ndeshur vetëm një rast të lidhore-habitores kohë e tashme që ka për afiks të pakryerën e foljes *kam*: *paskam qef t'math t'i ngjoksha*.

Format e pashtjelluara

Pjesorja

Foljet që dalin në temë më zanore nuk marrin prapashtesë formëformuese: *ble, coptû, çû, da, dorzû, fîllû, kashtû, lirû, marû, nalû, natrrû, ngjû, shkû*; po kështu edhe foljet konsonantike nuk marrin asnjë prapashtesë formëformuese: *dâl, fol, hum, hyp, loth, mjëll, nref, pjëll, pyt, qit, thirr*. Në shumicën e rasteve gjatësia kompensatore e zanores së theksuar nuk ruhet dhe si rezultat ajo aktualisht dëgjohej e shkurtër; ky fenomen ka për bazë analogjinë.

Foljet e parregullta dhe supletive kanë *-n* (<në): *dhâ:n, thâ:n, zâ°:n*; folja *ha* në pjesore del në dy trajta: *hañer* dhe *hañ*, ndër të cilat e para më e rëndomtë. Karakteristike për këtë të folme është pjesorja *ra* e foljes *bie*, që del rregullisht pa prapashtesë dhe me zanore gojore. Folja *rri* në pjesore del jo më *t*, siç del, fjala vjen, në Elbasan, por pa *-t*: *nej*. Ndërsa folja *humb* në S. del në trajtën *humat*, që është formë e përfutur në bazë aoristi me *-ta*. Me *-n* del rregullisht edhe pjesorja *lâ:n* e foljes *lâ* (=lë).

Paskajorja

Paskajorja e gegërishtes me pjesëzën *me* është paskajorja zotëruese në Ndoq e Pezë. Një përdorim po kaq të dendur kjo paskajore ka edhe në të folme të tjera gege të gegërishtes jugperëndimore, si p.sh. në Peqin, Kavajë, Rrogozhinë, Prezë etj. Shembuj: dot shkojm *me mârri* nusen (.K.), dje kan fillû

me dā (K.), ene u bâm gati *me dāl* na (M.), pot dush *me lak* ate e lak (M.), lakmon *me hâ°njër* (S.), s'kam muft *me gjet* (S.).

Në këtë të folme takohet edhe paskajorja e tipit *për + emër foljor asnjanes i pashquar*: ky tip përdoret shumë më rrallë se paskajorja gege: u ba djali *për t'martū* (K.), n'qof se ash *për t'u pëlqy* (K.), jan bâ° *për t'hanjër* (M.), *për t'lrirū* / t'lirova tha (M.), e fus *për ta lÿ* me boi t'zëz (S.), paç *për t'i ra* parn e herës (S.).

Krahas paskajoreve të mësipërme, përdoren edhe tipat: a) *për + me + pjesore*; b) *pa + pjesore*: aj na e merrte n'krÿ *për me e shit* pazarit (K.), s'shkojte dît djele *pa u vra* (S.), kishin shumë *pa mjëll* (M.).

Përcjellorja

Variantet kryesore të pjesëzës së përcjellores janë *tuj* (S., K.), *tue* S., K.), *tye* (M.); shembuj: qef je *tuj bâ°* (K.), a *tuj tjek* mëze (K.), kam qën *tuj ña* qët (S.), zû *tuj pakū* (S.), jemi *tuj pa* shishoqin (M.); jam *tue zâ°n* kulart (K.), ato shkoshin *tue qā* mas gamorit (K.), jam *tue jesh* bukën (S.); a'prain *tye arth* (M.), jena *tye çū* (M.).

Në S. përdoren vetëm këto tri variante të pjesëzës së përcjellores (*tuj*, *tue*, *tye*), por në K. dhe M. takohen rrallë herë edhe variantet fonetike *tyj*, *tu*, si: zû *tuj shlū* (M.), *tyj kërkū* për pÿll (M.), *tyj punū* me çakiç (K.); jam *tu shî* misër (M.), ato malōkt ishin *tu prē* bār (K.).

Përcjellorja ka një përdorim mjaft të gjerë në Sauqet, që ndodhet afër Shijakut. Në këtë katund përcjellorja përdoret gjerësisht në vend të së tashmes së vazhdimësisë: *tuj ra shi* (= po bie shi), *tuj ña qët* (= po nget qetë), *tue ñarkū* gomarn (= po ngarkon gomarin). Këtu besojmë kemi një përdorim të përcjellores në vend të konstruktit të reduktuar *jam + përcjellore*, duke përdorur vetëm komponentin e dytë të formës analitike të vazhdimësisë. Këtë e mbështet edhe fakti se *jam + përcjellore* përdoret gjithashtu mjaft shpesh. Këtij konstrukt në Elbasan do t'i korrespondonte forma e së tashmes, si: *je tue bâ°* shumë herësh kshu (Elbasan = po ban); *je tuj m'lujt* o Bajrâ°m (Elb. = po m'lun).

Ndajfoljet

Ndajfolje kohe

Në të folmen e Ndroqit e Pezës paraqesin interes këto ndajfolje kohe: (1) *ime* (= tashti), e cila dëgjohej në ndonjë rast edhe në variantet: *imèni* (K.), *nime* (M.), që kanë përkatësisht një rritje të temës më *-ni* dhe një protezë më *-n*. Ndajfoljet *tashti*, *tani*, që i korrespondojnë kuptimisht ndajfoljes *ime*, nuk takohen fare në Ndroq e Pezë: ç't' bâ°jm *ime*, oj grū? (K.), Tirâ°na *ime* â°sh hap (M.), kat maj un *ime* (S.); *imeni* voji fiket (K.), *nime* u bâ°ka (M.). (2) *herët* (=

përpara): *herët* kan qén mexhite / tresha / atllik / metalik / t'zes (K.), *herët* salltanet s'ka pas jo (K.), *herët* hasrat i merrshim m'Kavaĵ (M.), *hejrët* ka pas qen kshu mre la (S.). (3) *nesret*, në K. edhe *nesjet* (= të nesërmen; në Elbasan *nesërëjt*): ...kur *nesret* vërte vinte me list n'dor (M.), *nesret* hâ°njëm i drëk n'Valijas (S.), *nesjet* n'mjes e ka qit tuj lë dilli (S.), *nesjet* ky vdiq (S.), *nesjet* dül m'dyqan (S.). (4) *masanej* (= pastaj), që takohet herë-herë edhe në variante të tjera fonetike: *masanej* (K.), *mësënej* (M.), *masaneti* (S.), *mësënejt* (S.): *masanej* fëmija u bajte dhit vjeç (K.), *masanej* dül goca ke burri (K.), *masanej* e merr vesht ky se goca ash gjall (K.); *masaneti* e vrân ne ate (S.), dulëm Pazar *masanej* (M.), *masanej* qiti tapanxhën Shyqyriu (M.). (5) *pasnesër* (= një ditë më vonë nga nesër); *parcinesër* (= një ditë më vonë nga pasnesër, tjetërpasnesër); (6) *pardjëj* (ditën përpara ditës së djeshme), *parcidjëj* (ditën përpara ditës së pardjeshme).

Ndajfolje vendi

(1) *kâ°* (= këtu): un kërkoshe *kâ°* (M.), aj tuj shti *kâ°* (S.), po ja t'shtiim shkurtas *kâ°* (K.). (2) *tërpo* (= përposhtë), që takohet edhe në Malësi të Kavajës: ne vjen *tërpo* ai (K.); në K. takohet edhe *përtërpo*: ka hum *përtërpo*; në M. *tërpösht*; (3) *tërpjet* (= përpjetë): mos ik *tërpjet* (M.). (4) *tërhû* (= këndej): ato qi shkojshin s'vijshin ma *tërhû* (K.), kishin marr tøk ma *tërhû* (K.), hajde *tërhû* (S.), vishin kalamajt e atyne *tërhû* (M.), un po u kthejshe *tërhû* (M.); në S. përdoret gjithashtu edhe *tatû*: afrohu *tatû*. (5) *kun* (= gjëkund): mos ka shkû *kun* (K.). Por krahas *kun*, takohet edhe *gjëkuni*: këtu mëshitetena apo shkoim *gjëkuni* (K.). (6) *gjetiu* (= në tjetër vend): ik *gjetiu* (S.). (7) *gjithanej* (= kudo): krÿt e punës po n'dor tøn ash *gjithanej* (K.); me të njëjtin kuptim përdoret edhe *kanekan*: ju doq xhupi me gjith pare *kanekan* (K.). (8) *po* (= poshtë), ka ne *po* (M.), e kam lâ:n aty *po* (M.).

Ndajfolje sasi

(1) *majaft* (= mjaft) është variant i vetëm fonetik që takohet në të gjitha pikat e banuara të Ndroqit e Pezës, dhe që takohet ndër shumë të folme të gegërishtes jugperëndimore; (2) *psi* (= përsëri, në M. edhe *psita*: t'vî *psi* (S.), at'here gërmoj *psi* un (K.); shkoj javën tjetër *psi* ky n'pazar (M.) vjesht / *psita* vjesht (M.).

Parafjalët

(1) Parafjala *m* (<*më*), sikurse në Peqin, Durrës, Malësi të Kavajës etj., ka një përdorim shumë të gjerë krahas parafjalës *n* (<*në*); ajo tregon marrëdhënie vendore e kohore, duke ngushtuar në këtë mënyrë mjaft përdorimin e *-n*; shembuj ku *m* shpreh marrëdhënie vendore: *m'* Shjak i kam pas ble un prej merakut (M.), dulën *m'* rrugët (M.), nrehen *m'* kâ:°m (K.), do ta shtijm *m'* shpi

nusen (K.). Parafjala *m* përdoret edhe përpara emrave që nisin me zanore: *m' òd miqet* (S.), *sall m' Elbasan* (S.), *i t' mǎrr hejbet ene derth flerít m' új* (M.); shembuj ku *m* shpreh marrëdhënie kohore: *t' myt m' dimën* (M.) *m'at dite / bite i vës shi* (M.), *m' krýt pesmdhit dite* (K.), *m' trít çdo gjá* (K.), *ka tet lëk m' dit* (S.), *m' krýt tri ore* (S.). Në të njëjtat funksione përdoret rrallë edhe *n* (disa raste kam takuar në K.: *iku prej atje erth n' shpi* (S.), *s' rri n' shpi* (M.), e *mur n' krahe* (K.), *i çoi n' shkòll* (K.), *topi t' vret ktu e n' Shijak* (K.), *dy qile misër n' dít* (K.), *i litër n' javët* (K.). Në disa ndërtime parafjalët *m*, *n* reduktohen plotësisht; kjo ndodh në të folurit e shpejtë, sidomos kur parafjala paraprihet nga folje të lëvizjeve: *po shkoj mullí* (M.), *t' vish kâ'm* (M.), *ene do vÿjshe shpi* (M.), *kto tjerët metën pÿll* (K.).

Parafjala *më* del edhe në variantin fonetik *me*, sa herë që pasohet nga një emër i trajtës së pashquar, që paraprihet nga nyja *nji* e reduktuar (j). Ky ndërrim fonetik i *më* në *me* është i rregullt: *grāt e kalamajt dulën mej përrú* (M.), *ti mej krahe / un mej krahe* (M.), *kishte ñel i purri lesh mej shkúrr* (S.).

Parafjala *n*, në kuadrin e përdorimit të zakonshëm të saj, përdoret rëndom kur pasohet nga e ashtuquajtura 'rasë vendore': *ai pat nej n' burgut* (M.), *hyn mrena e ñel n' letht* (M.), *na kapi n' qafët* (S.), *i kanil n' prrút* (S.), *kishte tre naplona n' mujët* (K.), *u poq me mu n' rrugët* (K.). Po kaq dendur me rasën vendore përdoret edhe *m*: *bâ'jte vaki ne dy hër m' javët* (M.), *dil aty m' vāt / se e kam lâ:n vān aty po* (M.), *ñeli m' gjolt* (S.), *asaj ju vra i vllaĳ m' lâmt t' lashtës tuj shí* (S.), *ra m' pust ai* (K.).

(2) Dendur përdoret variant *ke* i parafjalës *tek*. Ajo përdoret para emrave në rasën emërore trajtë e shquar, që fillojnë me bashkëtingëllore ose me zanore: *dÿl goca ke burri* (K.), e shtishe atje *ke miku* (K.), *rrite ke miqt* (S.), *ku m' shkote menja ke pula mu* (M.), *se erdhën aty ke Arzenja* (K.).

Toponimet dalin zakonisht në formën e rasës emërore të paraprirë nga parafjala *ke*; në kallëzore ato shoqërohen zakonisht nga *m*. Disa shembuj toponimesh të mbledhura në të njëjtin katund, në S.: *ke Xhamia*, *ke Gjerdhet* e *Mllínit*, *ke Moknat*, *ke Ligata*, *ke Kroĳ Qishës*, *ke Kroĳ Kǎurrit*; *m' Kodër Lugës*, *m' Djerras*, *m' Tallas*, *m' Djerr Pjak* etj.

(3) Parafjala *prej*, që dëgjohet edhe në variantin *prij*, përdoret edhe në vend të parafjalës *nga* për të treguar: (a) marrëdhënie vendore me nuanca të ndryshme, si prejardhje, origjinë, drejtim: *vÿshin muhaxhirt prej Shjaku* (K.), *mora dy shòk prij katuni* (S.), *kte e kam pas ni prej t' vjetrish* (M.), *î:n qe prej Pineti* (S.), *mur at kan atje prej gardhit* (M.), *kishin zâ'n prij shkâ'mit matān* (S.); (b) marrëdhënie shkakore: *vdiq prij frúthit* (K.), *sú ni prij shamatës* (S.), *aj s'un hecte prej kâ'mësh ene e tërhoqën rrëshqān* (K.); (c) për të treguar lëndën me të cilën ndërtohet një send: *xhòk prej leshi* (M.), *korita prej druni bâhet* (K.).

(4) Parafjalët *matan*, *përmi*, *përfun*, *knej* në këtë të folme i kërkojnë emrat në formën rasore të kallëzores: *ta thāsh qy mrām un / atje matan lumin* (M.), *matan Erzén* (K.), e kishte pas barken *matan urën* (S.), *përmi arën* e çunit *Metës*

(S.), *përfun Kryzīn* (K.), *knej Pezēn* (M.).

Lidhëzat

(1) Në vend të lidhëzave bashkërenditëse *edhe, dhe*, që nuk takohen fare në Ndroq e Pezë, përdoren *ene, ne*, ndër të cilat e para më shpesh: tymin e shifte ke dilte / *ene* flakën bile (M.), erdhën ktu ke shpia / granit *ene* kalamajt (M.); shko m'teqet *ene* bërtit ke dera (K.), un shkova m'pÿll *ene* preva i drū t'math (S.). Lidhëza *ne* përdoret sidomos kur pasohet nga nyja /j/ e trajtës së pashquar: ka *nej* gōc dyzet vjeç pa martu (M.), atje qēn gjeli *nej* pūl (S.), burri t'kēt shkōll / *ne* gruja t'kēt shkōll (K.), rroi *ne* ja dy tre vjet (S.).

(2) Në këtë të folme përdoret shpesh lidhëza dygjymtyrëshe bashkërenditëse shtuese *hem...hem*, që bashkon dy fjali të bashkërenditura ose dy gjymtyrë të një fjalie: *hem* shkruhim atje / *hem* rrishim n'hijet (K.), *hem* t'marsh / *hem* t'apsh (K.), *hem* t'zes / *hem* t'bārdh (S.).

(3) Në rolin e një lidhëze bashkërenditëse veçuese del edhe togu *n'daç*, i cili, pasi e ka humbur kuptimin leksikor të parë, është shndërruar në një lidhëz, që zakonisht është dygjymtyrëshe: *n'daç* t'shkoj me lōp / *n'daç* bŭlk (S.), *n'daç* prej burrash / *n'daç* prej grāsh (K.), e bërzi me grūn / *n'daç* me elb (S.).

(4) Interes përfaqëson lokucioni lidhëzor '*i sen qi*' me funksion rrjedhor, i formuar nga gramatikalizimi i emrit *send* në trajtë të pashquar: arra ka hije t'rā°n / *i sen qi* e mīll misër nuk bā°n // e vret hija arrēs (M.), shkoin keq njeni me tjetrin / *i sen qi* për nāt do zīhen (K.), ishte shtrejtisia madhe / *i sen qi* asgjā° s'bjeva (S.).

(5) Sikurse në të folmen e Peqinit, edhe këtu ndeshet shpesh lidhëza kohore *kurse* në vend të lidhëzës së thjeshtë kohore *kur*: *kurse* nuk bā°n fmi / martohet dy hēr (K.), *kurse* s'je i zoti me i majt / mos u marto (K.), *kurse* erth i jati / t'gjithve u hyni fryka (M.).

(6) Ndër lidhëzat nënrenditëse paraqet interes edhe lidhëza kohore *se* në funksion të lokucionit lidhëzor '*qysh kur*': un *se* kam le / me kto men kam shkū (K.), *se* ka ārdh ktu / s'e ka hap gojën (M.); krahas lidhëzës *se* përdoret edhe lokucioni '*qysh se*': *qysh se* u ulsh / s'ishje m'qef (K.), *qysh se* hÿ:n m'koprativ / blen i maqīn (S.).

Pjesëzat

(1) Pjesëza *mu* precizon, saktëson, në planin hapësinor diçka që thuhet në një kontekst të dhënë: i ra *mu* n'zemër (K.), e lidhën *mu* n'bēth ullinit (M.), ene e vrān *mu* n'shpi t'vet (S.). Në planin kohor precizon veprimin pjesëza *qy*, e cila dëgjohet edhe në variantin *çy*: ta thāsh *qy* mrām un (M.); ... *çy* m'at koh jam smū (M.).

(2) Në vend të pjesëzës caktuese kufizuese *vetëm*, kemi takuar fjalën *sall*:

sall kte kena (M.), *sall* un erdha (K.), baba *sall* mu m'kishte (K.).

(3) Pjesëza *ja* tregon diçka të përafërt, d.m.th. zvogëlon saktësimin në planin hapësinor dhe kohor: kur sa largova *ja* i qin metra ... (S.), jâti ne *ja* i mûj (S.).

(4) Në vend të pjesëzës *ndofta* / *ndoshta* përdoret pjesëza *dro*, që shpreh nuancë dyshimi e supozimi: aj *dro* munt t'vî (M.), e ka marû *dro* (M.), *dro* a i mrasëm *dro* (S.).

(5) Interes përfaqëson edhe pozicioni i pjesëzës thirrëse *o*, që shumë herë në këtë të folme vendoset në fund të emrave të përveçëm të njerëzve: more vesh gjâ ti *Zimo!* (K.), ku je *Meto* / kam gjith këtë bir dite qi t'kërkoj (M.).

Fjalëformimi

(1) Prapashtesa *-as*, duke iu prapangjitur emrave të përveçëm të vendeve, jep banuesit e atij vendi: *Ballashen-as*, *Kërçuk(je)-as*, *Maknor-as*, *Mater-as*, *Pinet-as*, *Sauqet-as*, *Varosh-as*. Me këtë prapashtesë formohen emra topikë nga emra të përgjithshëm: *Brîjas*, *Djerras*, *Fushas*, *Ligatas*, *Tallas*.

(2) Me prapashtesën *-(ë)sîn* prej mbiemrash a ndajfoljesh formohen emra abstraktë që tregojnë tipar a send konkret: *butsîn*, *ftohosîn*, *thatsîn*, *hijesîn*, *ligatsîn*, *tërpjetësîn*.

Emra të tillë formohen prej mbemrash gjithashtu edhe me prapashtesat-ësi, *-in(ë)*: *ligsi*, *lagshîn*, *shëmîn*.

(3) Me prapashtesën *-ore* formohen emra që tregojnë vendin ku kultivohet një bimë: *hamllore*, *misërore* (në S. edhe *misore*), *elbore*, *tepore*.

Me *-ore* formohen gjithashtu edhe emra, që tregojnë një send konkret: *elbore* (lloj dardhe, K.), *vathore* (dhja me vathë), *barkore* (litari që i shkon ndër bark kafshëve të barrës), *capore* (dhi me brinj përpjetë sitë capit); *latore* (vegël me të cilën priten dru).

(4) Prapashtesa *-llik* gjendet jo vetëm në fjalët turke, por edhe ato shqipe; ajo ruan trajtën e origjinës *-llik* (jo *-lluk*): *ushtarllik*, *gamarllik*, *pazarllik*, *budallallik*.

(5) Në disa raste temës së mbiemrit i prapashtohet prapashtesa *-t(ë)*: *i amëlt* (S.), *i felt* (S.).

(6) Prapashtesa *-z* takohet shumë herë në funksion fjalëformues; me anën e saj përftohen emra me kuptim të ndryshëm nga ajo e temës prodhuese: *gojëz-a* (çile leshi), *dorëz -a* (disa kallij gruri), *pallëz-a* (pjesë e hostenit), *qimëz-a* (sëmundje e dhisë që prek mëlçitë e saj), *tuwëz-a* (lule e degës së misrit).

(7) Me prapashtesën *-(ë)s* përftohen prej foljesh a emrash, emra vepruesish ose emra që tregojnë një send konkret: *përcjells*, *prës*, *shtyps*, *shkes*, *qelps 1*, *qelps 2* (shih fjalorthin), *uj*; në ndonjë rast prapashtesa *-s* shkrihet me *-t* e temës dhe përftohet *c*: *mac-i* (një lloj krimbi), *shpirc-a* (shkrepse).

(8) Prej mbiemrash dhe emrash përftohen me prapashtesën *-e* emra që

emërtojnë kafshë, si dhi e lopë: *kuqe* (lopë a dhi në ngjyrë të kuqe), *çile* (dhi e zbardhur), *korb-e* (dhi ose lopë me sy të zes), *thim-e* (dhi e thime), *murg-e* (dhi në ngjyrë të errët); *bardhak-e* (dhi krejt e bardhë), *kalem-e* (dhi me sy të zes), *lëmone* (dhi në ngjyrë të limonit).

(9) Disa fjalë, sidomos emra, përftohen me anën e konversionit: *kep-i*, *kāp-a*, *mūn-a*, *hērr-a*, *pūt-a*.

(10) Në Ndroq e Pezë takohen edhe disa kompozita, komponentët e të cilëve janë: (a) emër-mbiemër, (b) emër-emër, dhe (c) emër-folje: (a) *nusbukra* (nusja e lalës, bukla), *syzeza* (dele me sy dhe faqe të zeza), *sykuqja* (dele me sy të kuqe), *shurrkuqja* (sëmundje kafshësh); (b) *sygrosha* (dele me fytyrë pika-pika), *kamleshi* (duhan shumë i fortë, që nuk i bie vrugu), *katnanja* (=vjehrra), *bukvalja* (gjymshe uji), *koqeveja* (kokërr veze); (c) *lâ°ytuni* (hirra). Në këtë të folme ndeshet edhe folja *haperdai* (shpërndaj, hallakat), që mund të jetë përftuar nga kontaminimi i foljeve *hap* + *përdaj*.

(Vijon në numrin e ardhshëm)